

UDHËZUES PËR

**ORGANIZIMIN
E ORËVE TË
PËRBASHKËTA
MËSIMORE**



UDHËZUES PËR
ORGANIZIMIN
E ORËVE TË
PËRBASHKËTA MËSIMORE

Titulli: Упатство за организирање заеднички наставни часови - Уdhëzues për organizimin e orëve të përbashkëta mësimore

Autorë:

Nazihtere Sulejmani (Ministria e Arsimit dhe Shkencës)
Biljana Trajkovska (Ministria e Arsimit dhe Shkencës)
Ajshe Ajrullai (Biroja e Zhvillimit të Arsimit)
Ardijana Isahi Palloshi (Qendra për Arsimit Profesional dhe Trajnim)
Daniela Adamova (Sektori për arsim pranë Qytetit të Shkupit)

Bashkëpunëtorë:

Tulaha Tahir (Qendra Maqedonase për Edukimit Qytetar)
Majda Joshevska - Stojoska (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë - Misioni në Shkup)
Besnik Ramadani (Qendra Maqedonase për Edukimit Qytetar / Fondacioni i Fëmijëve „Pestaloci“)
Aneta Trpevska (Qendra Maqedonase për Edukimit Qytetar / Projekti i USAID-it për Integrim Ndëretnik të të Rinjve në Arsimit)
Besa Reçi (Qendra Maqedonase për Edukimit Qytetar / Projekti i USAID-it për Integrim Ndëretnik të të Rinjve në Arsimit)
Nebojska Mojsoski (Qendra Maqedonase për Edukimit Qytetar / Projekti i USAID-it për Integrim Ndëretnik të të Rinjve në Arsimit)

Përkthim (nga gjuha maqedonase): Fatlume Adili

Lekturë: Luljeta Ademi

Dizajn grafik: Polyesterday

Tirazhi: 300

Botues: Македонски центар за граѓанско образование

Botuar: 2021

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3/5.091.322=00(083.131)

373.3/5.064.2/3:316.723-021.463(083.131)

UDHËZUES për organizimin e orëve të përbashkëta mësimore / [autorë
Nazihtere Sulejmani ... и др. ; bashkëpunëtorë Tulaha Tahir ... и др. ;
përkthim (nga gjuha maqedonase) Fatlume Adili]. - Shkup : Qendra
maqedonase për edukim qytetar (QMEQ), 2021. - 44 стр. : илустр. ; 30 см

Превод на делото: Упатство за организирање заеднички наставни часови. -
Фусноти кон текстот. - Други автори: Biljana Trajkovska, Ajshe Ajrullai,
Ardijana Isahi Palloshi, Daniela Adamova. - Други соработници: Majda
Joshevska-Stojoska, Besnik Ramadani, Aneta Trpevska, Besa Reçi, Nebojska
Mojsoski. - Содржи и: Shtojca 1-3

ISBN 978-608-4940-08-1

1. Sulejmani, Nazihtere [автор] 2. Trajkovska, Biljana [автор] 3.
Ajrullai, Ajshe [автор] 4. Isahi Palloshi, Ardijana [автор] 5. Adamova,
Daniela [автор]
а) Основно и средно образование -- Активности -- Различни наставни
јазици -- Упатства б) Мултиетнички односи -- Основно и средно
образование -- Упатства
COBISS.MK-ID 55818245

Ky udhëzues është përpiluar nga ekipi i Qendrës Maqedonase për Edukimit Qytetar (QMEQ) në kuadër të Projektit të USAID-it për Integrimin Ndëretnik të të Rinjve në Arsimit dhe Projektit për forcimin e bashkëpunimit multi-etnik në komunat të Fondacionit për Fëmijë Pestaloci, në partneritet me Misionin e OSBE-së në Shkup, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Byronë e Zhvillimit të Arsimit, Qendrën për Arsimit Profesional dhe Trajnim dhe Qytetin e Shkupit.

Përmbajtja dhe qëndrimet e shprehura në këtë udhëzues u përkasin autorëve dhe nuk i shprehin qëndrimet e Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Misionit të OSBE-së në Shkup dhe Fondacionit për Fëmijë Pestaloci. Udhëzuesi është përgatitur me mbështetjen e popullit amerikan përmes Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).



БИРО ЗА РАЗВОЈ НА ОБРАЗОВАНИЕ
МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА - REPUBLIKA E MAQEDONISE SE VERIUT
МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА
Биро за развој на образованието
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Byroja e zhvillimit të arsimit

Бр./Nr. 02-1437/1
20. 9. 2021 год./viti
СКОПЈЕ - ШКУП



Центар за стручно образование и обука
Qendrapër Arsim Profesional dhe Trajnim
Vocational Education and Training
Centre
РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISE SE VERIUT
ЦЕНТАР ЗА СТРУЧНО ОБРАЗОВАНИЕ И ОБУКА
QENDRA PER ARSIM PROFESIONAL DHE TRAJNIM

Бр./Nr. 09-535/1
20-09-2021 год./viti
СКОПЈЕ - ШКУП

Врз основа на Акцискиот план на Националната стратегија за развој на концептот

Едно општество за сите и интеркултурализам, Приоритет 1: Обезбедување интеракција меѓу учениците од различни етнички заедници и различни наставни јазици во основното и средното образование, цел 2.1 Зајакнување на заедничките наставни активности во училишта, мерка 2.1.1.1 Подготовка на упатство за организирање на заеднички наставни часови, в.д. директорот на Бирото за развој на образованието и директорот на Центарот за стручно образование и обука донесоа

„Упатство за организирање заеднички наставни часови.“

Прилог: Упатство за организирање заеднички наставни часови (на македонски и албански јазик)



Биро за развој на образованието
В.Д. ДИРЕКТОР

Зекирија Хасипи

Центар за стручно образование и обука
ДИРЕКТОР



Шериф Мифтари

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	5
2. QËLLIMET E UDHËZUESIT	7
3. KUJT I DREJTOHET UDHËZUESI?	7
4. BAZAT E ORËVE TË PËRBASHKËTA MËSIMORE NË POLITIKAT ARSIMORE	8
5. PËRFITIMET NGA REALIZIMI I ORËVE TË PËRBASHKËTA	10
6. ROLI I INSTITUCIONEVE TË TË GJITHA NIVELEVE NË MBËSHTETJE TË ORËVE TË PËRBASHKËTA MËSIMORE	13
6.1 ROLI I INSTITUCIONEVE NË NIVEL QENDROR	13
6.2 ROLI I KOMUNAVE DHE QYTETIT TË SHKUPIT	14
6.2.1 Roli i komunës në mbështetje të aktiviteteve të përbashkëta	14
6.2.2. Aktivitetet e komunave dhe Qytetit të Shkupit në procesin e zbatimit të orëve të përbashkëta mësimore	15
6.3. ROLI I SHKOLLËS	16
6.3.1. Aktivitet në nivel shkollor	17
6.3.2. Planifikimi i orëve të përbashkëta	19
6.3.3. Organizimi i orëve të përbashkëta mësimore	24
6.3.4. Mbajtja e orëve të përbashkëta	24
6.3.5. Realizimi i orëve të përbashkëta në distancë	25
6.3.6. Vlerësimi i nxënësve sipas zhvillimit të kompetencave interkulturore	26
SHTOJCAT	27
Shtojca 1. Raporti për ndjekjen e orës së përbashkët	28
Shtojca 2. Roli dhe detyrat e komunave dhe Qytetit të Shkupit në mbështetjen e shkollave gjatë organizimit të orëve të përbashkëta mësimore	36
Shtojca 3. Lloje të aktiviteteve për perceptimin e më shumë perspektivave	42



1. HYRJE

Një nga prioritetet e sistemit arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut është ndërtimi i një modeli cilësor arsimor, i cili kultivon dhe inkurajon vlerat interkulturore përmes mbështetjes së ndërveprimit, bashkëpunimit reciprok dhe besimit mes nxënësve, mësimitdhënësve dhe prindërve të etnive të ndryshme dhe gjuhëve të ndryshme mësimore, dhe e gjithë kjo siguron dhe zhvillon një klimë pozitive në shkollë.

Përgatitja dhe miratimi i Udhëzuesit për organizimin e orëve të përbashkëta mësimore¹ bazohet mbi planin e veprimit të Strategjisë për zhvillimin e konceptit për një shoqëri dhe intrekulturalizmit.

Krijimi i një klime edukativo-arsimore e cila ushqen marrëdhëniet ndërkulturore dhe proceset e integritimit, ku promovohen dallimet kulturore, arrihet përmes qasjeve të ndryshme.

Marrëdhëniet ndërkulturore dhe interkulturalizmi në arsim² forcohen nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të integritimit ndëretnik. Në fakt, ato **janë aktivitete mësimore dhe jashtëmësimore të përbashkëta**³ me të ashtuquajtura grupe "të përziera" nxënësish që mësojnë në gjuhë të ndryshme. Aktivitete të tilla janë shumë të rëndësishme për të siguruar ndërveprime mes nxënësve, të cilët ndryshe nuk kanë mundësi tjetër të kontaktojnë me njëri-tjetrin gjatë arsimit formal. Mundësia e zbatimit të këtyre lloj aktiviteteve është më e madhe në shkollat ku mësohet në dy-tri gjuhë sesa në shkollat ku mësohet vetëm në një gjuhë. Në shkollat ku mësimi realizohet në dy-tri gjuhë, mbahen orë të përbashkëta mësimore dhe zhvillohen projekte dhe hulumtime të përbashkëta si pjesë e mësimitdhënies të lëndëve të detyrueshme dhe atyre zgjedhore. Pikërisht, për shkak të kushteve për realizimin e llojeve të ndryshme të aktiviteteve të integritimit ndëretnik që ekzistojnë në shkollat ku mësohet në dy-tri gjuhë, sistemi i arsimit stimulon sa më shumë nxënës që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore, të mësojnë nën të njëjtin kulm.

Për të përmirësuar ndërveprimin mes nxënësve që ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme mësimore, shkollat me një gjuhë mësimore stimulohen të formojnë partnerit me shkollat me gjuhë të tjera mësimore dhe së bashku të planifikojnë, të organizojnë dhe të zbatojnë aktivitete mësimore në cilat marrin pjesë grupe "të përziera" nxënësish që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore. Në shkollat ku mësimi mbahet në një gjuhë mësimore nga e njëjta komunë ose i njëjti rajon, mund të organizohen orët e përbashkëta në kuadër të komunës me prezencë fizike me përgatitje të mirë paraprahe.

1 Me termin „orë të përbashkëta mësimore“ nënkuptojmë aktivitete të përbashkëta mësimore të cilat mbahen me nxënësit e gjuhëve të ndryshme mësimore nga klasa e parë deri tek e treta në arsimin fillor, si dhe orët të përbashkëta mësimore që mbahen në klasat e tjera të arsimit fillor dhe të mesëm.

2 Strategjia kombëtare për zhvillimin e konceptit për një shoqëri dhe interkulturalizmin 2020-2022 https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/strategjii/strategjia_ednoopshtestvo_29.10.2019.pdf

3 Koncepti për arsim fillor <https://mon.gov.mk/stored/document/Koncepcija%20MK.pdf>, Ligji për arsim fillor <https://mon.gov.mk/stored/document/Zakon%20za%20osnovnoto%20obrazovanie%20-%20nov.pdf>, Ligji për arsim të mesëm <https://mon.gov.mk/stored/document/Zakon%20za%20srednoto%20obrazovanie.pdf>

Nga ana tjetër, mësimi në distancë jep mundësi shtesë që të mbahen orë të përbashkëta dhe mes nxënësve që janë në distancë fizike/gjeografike.

Interkulturalizmi zhvillohet edhe nëpërmjet organizimit të punës së përgjithshme në shkollat ku mësimi zhvillohet në dy-tri gjuhë. Në këtë mënyrë krijohen kushtet e komunikimit formal dhe joformal të mësimdhënësve dhe nxënësve me etni të ndryshme nëpërmjet përfaqësimit të detyrueshëm të të gjitha gjuhëve mësimore në të njëjtin ndërrim (turn), nëpërmjet aktiveve profesionale me mësimdhënësit nga të gjitha gjuhët mësimore dhe nëpërmjet organeve të përbashkëta ku janë të përfshirë prindërit/kujdestarët nga të gjitha gjuhët mësimore.

Mbajtja e orëve të përbashkëta është një nga mënyrat për të arritur kohezionin mes nxënësve që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore dhe kjo tashmë është e pranishme në disa shkolla. Orët e përbashkëta realizohen me bashkimin e dy paraleleve me gjuhë të ndryshme mësimore, duke respektuar rregulloret ligjore për numrin e nxënësve në paralele dhe kriteret e mbajtjes së mësimi të përbashkët në paralelen me përbërje të përzierë etnike dhe në dy gjuhë mësimore. Mësimi mbahet nga dy mësimdhënës dhe ata janë mësimdhënës që japin të njëjtën lëndë në dy gjuhë mësimore.

Për të mbajtur orët e përbashkëta mësimore është e nevojshme të forcohen kompetencat e mësimdhënësve⁴ nëpërmjet trajnimeve dhe sigurimit të materialeve profesionale, gatishmërisë, angazhimit dhe dëshirës për të zbatuar aktivitetet.

Parimet dhe kriteret e përdorura gjatë realizimit të mësimdhënies së përbashkët në shkolla duhet të jenë bazë e standardeve për orë të përbashkëta mësimore, të cilat më tej do të futen në sistemin e arsimit, e gjithë kjo në funksion të përforcimit të integritetit ndëretnik dhe interkulturalizmit në arsim⁵.

Një shembull i mirë për realizim janë orët e përbashkëta mësimore të mbështetura nga Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ) në suazat e projekteve të USAD-it për Integrimin Ndëretnik në Arsim (PINA) dhe Integrimin Ndëretnik të të Rinjve në Arsim (INRA)⁶, projekti i Fondacionit për Fëmijët Pestaloci – Përforcimi i bashkëpunimit multietnik në komuna⁷, si dhe projekte të tjera.

4 Kompetencat dhe standardet themelore për arsimtarin mentor dhe arsimtarin këshilltar përfshijnë kompetencat për integrimin ndëretnik dhe pjesëmarrjen demokratike të nxënësve në fusha e krijimit të një mjedisi dhe atmosfere të sigurt dhe stimuluese për mësim.

5 <https://www.bro.gov.mk/>

6 Orë mësimore të përbashkëta mbahen në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit (Arsenie Jovkov", „Boro Petrushevski", „Zdravko Cvetkovski", „Vëllezërit Milladinov", „Vlado Tasevki", „Dimitar Vllahov", „Josip Bros Tito").

7 Orë mësimore të përbashkëta mbahen në shkollat fillore në këto nëntë komuna: Strumicë („Marshall Tito", „Marshall Tito", f. Murtino, „Nikolla Vapcarov"), Manastir („Gjeorgji Sugarev", „Goce Dellçev", „Kërste Petkov Misirkov", f.Bistricë), Gostivar („Bashkimi", „Edinstvo", „Mustafa Qemal Ataturk"), Butel („Petar Zdravkovski Penko", „Zhivko Brajkovski", „Panajot Ginovski"), Kumanovë („Toli Zordumis", „Kirilli dhe Metodi", „Vëllezërit Ribar", f.Tabanoc), Radovish („Nikolla Karev", „Kërste Petkov Misirkov", „Orce Nikollov", f.Injevë), Döllinen („Pere Toshev", f.Desovë, „Vera Ciriviri Treña", f.Debresh, „Liria", f.Zhitoshe), Tetovë („Kirilli dhe Metodi", „Bratstvo Migjeni", „Liria"), Strugë („Vëllezërit Milladinov", „Murat Llabunishta", f. Llabunishtë", „Edinstvo", f.Oktasi).



2. QËLLIMET E UDHËZUESIT

Udhëzuesi para së gjithash është përgatitur për të inkurajuar shkollat që të realizojnë orë të përbashkëta, si dhe për planifikim, organizim dhe zbatim më të lehtë, dhe vëzhgim, mbështetje dhe vlerësim të orëve të përbashkëta me nxënës të cilët ndjekin mësimdhënien në gjuhë të ndryshme mësimore, por gjithashtu për të përforsuar procesin e komunikimit dhe bashkëpunimit reciprok të të gjitha palëve të përfshira⁸ në sistemin arsimor në drejtim të krijimit të klimës për realizimin e orëve të përbashkëta.



3. KUJT I DREJTOHET UDHËZUESI?

UDHËZUESI IU DREJTOHET TË GJITHË PALËVE NË PROCESIN E REALIZIMIT TË ORËVE TË PËRBASHKËTA MËSIMORE.

Në nivel shkollor udhëzuesi do të ndihmojë drejtorët, ekipin për integrim shkollor, bashkëpunëtorët profesionalë dhe mësimdhënësit që të planifikojnë, organizojnë, realizojnë dhe vëzhgojnë orët e përbashkëta.

Në nivel komunal udhëzuesi mund të përdoret nga: personi përgjegjës për arsim në komunë, kryetari i komunës dhe komisioni për arsim, në mënyrë që të iniciohen, të planifikohen, të ndiqen dhe të mbështeten orët e përbashkëta në shkolla.

Në nivel qendror udhëzuesi do të përdoret nga institucionet për zbatimin e procesit të ndjekjes (vëzhgimit) dhe vlerësimit të realizimit të orëve të përbashkëta, mbështetjes dhe ndërtimit të kapaciteteve të shkollave, informimit për arritjet në fushat e integritit ndëretnik dhe interkulturalizmit.

Prandaj, mund të konstatohet se udhëzuesi do të siguroj zbatimin e përgjegjësive nga të gjitha palët e përfshira në procesin e planifikimit, organizimit, zhvillimit dhe regjistrimit të orëve të mbajtura të përbashkëta.

⁸ Me fjalën „të gjitha palët e përfshira në sistemin arsimor“ nënkuptojmë nxënësit, mësimdhënësit, bashkëpunëtorët profesionalë, kuadrin joarsimor të shkollave, drejtorët, prindërit/kujdestarët, por edhe anëtarët e Këshillit të Shkollës, si dhe përfaqësuesit e bashkësisë lokale dhe institucionet arsimore që janë përgjegjëse për procesin arsimor.



4. BAZAT E ORËVE TË PËRBASHKËTA MËSIMORE NË POLITIKAT ARSIMORE

Nevoja për ndërveprim më të madh dhe përforsim të kompetencave interkulturore të nxënësve të cilët ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme është identifikuar në shumicën e dokumenteve të rëndësishme strategjike, siç janë:

- ✓ Strategjia nacionale për zhvillim të konceptit për një shoqëri dhe interkulturalizmit 2020-2022⁹;
- ✓ Strategjia për arsim 2018 – 2025 dhe plani i veprimit¹⁰;
- ✓ Strategjia „Hapa drejt arsimit të integruar në sistemin arsimor në Republikën e Maqedonisë“;
- ✓ Koncepti për arsimin fillor¹¹;
- ✓ Koncepti për aktivitete jashtëmësimore në arsimin fillor¹²;
- ✓ Ligji për arsimin fillor¹³;
- ✓ Rregullore që dalin nga Ligji për arsim fillor¹⁴;
- ✓ Standarde nacionale për arritje të nxënësve në fund të arsimit fillor¹⁵;
- ✓ Udhëzues për lëndët zgjedhore të lira në arsimin fillor¹⁶;
- ✓ Ligji për arsim të mesëm¹⁷;
- ✓ Ligji për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional në shkollat fillore dhe të mesme¹⁸;
- ✓ Rregullore që dalin nga Ligji për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional në shkollat fillore dhe të mesme¹⁹.

Si vizion në Strategjinë për arsim 2018-2025 dhe planin e veprimit theksohet angazhimi për të siguruar arsim gjithëpërfshirës, inkluziv dhe të integruar të drejtuar drejt nxënësit/nxënës, me programe moderne që mundësojnë gjeneratat e reja të fitojnë njohuri, shkathtësi dhe kompetenca në përputhje me nevojat e shoqërisë multikulturore demokratike, tregun e punës dhe sfidat e reja në ambientin e përgjithshëm global teknologjiko-shkencor. Sipas vizionit të Strategjisë, ajo do të ketë në shënjestër

9 <https://vlada.mk/nacionalni-strategii>

10 <https://mon.gov.mk/page/?id=2048>

11 https://mon.gov.mk/stored/document/Koncepcija%20-%20albanski%20jazik_1.pdf

12 <https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2020/06/Koncepcija-za-vonnastavni-aktivnosti-2020-1.pdf>

13 <https://mon.gov.mk/stored/document/Zakon%20za%20osnovnoto%20obrazovanie%20-%20nov.pdf>

14 <https://mon.gov.mk/category/?id=2056>

15 <https://mon.gov.mk/stored/document/standardi-USVOENI.pdf>

16 <https://www.bro.gov.mk/%d0%b2%d0%be%d0%b4%d0%b8%d1%87-%d0%b7%d0%b0-%d1%81%d0%bb%d0%be%d0%b1%d0%be%d0%b4%d0%bd%d0%b8-%d0%b8%d0%b7%d0%be%d1%80%d0%bd%d0%b8-%d0%bf%d1%80%d0%b5%d0%b4%d0%bc%d0%b5%d1%82%d0%b8-%d0%b7%d0%b0/>

17 <https://mon.gov.mk/stored/document/Zakon%20za%20srednoto%20obrazovanie.pdf>

18 <https://mon.gov.mk/stored/document/Zakon%20za%20nastavnicite%20i%20str.pdf>

19 <https://mon.gov.mk/category/?id=2056>

edhe promovimin e multikulturalizmit, integrimin ndëretnik, respektimin e diversitetit dhe vlerave demokratike.

Në Ligji për arsim fillor i miratuar në vitin 2019 rregullohet ekipi për integrim shkollor, kompetencat e drejtorëve lidhur me INA-në (integrimi ndëretnik në arsim), po ashtu zbatimi dhe mbështetja e aktiviteteve që synojnë ndërveprim, domethënë integrim të nxënësve në grupe të përziera etnikisht/gjuhësisht. Ligji rregullon që edhe në programin vjetor të punës së shkollës, shkollat duhet të planifikojë edhe aktivitete për integrimin ndëretnik dhe nisma të përbashkëta të nxënësve.

Me Ligjin për arsim të mesëm, po ashtu, është rregulluar që shkollat mund të organizojë aktivitete që kontribuojnë në zhvillimin dhe promovimin e multikulturalizmit, integrimin ndëretnik dhe tolerancës.

Në Ligjin për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme përcaktohen kompetencat për fillestarë, mësimdhënës (arsimtar) dhe bashkëpunëtor profesional, po ashtu dhe zhvillimi profesional dhe në karrierë. Veçanërisht fushat: krijimi i mjedisit stimulues për nxënie (krijimi i mjedisit të sigurt dhe stimulues për nxënie dhe krijimi i klimës pozitive shkollore); inkluzion social dhe arsimor; komunikim dhe bashkëpunim me familjen dhe bashkësinë, janë fusha ngushtë të lidhura me kompetencat për zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të përbashkëta shkollore.

Koncepti i ri për arsim fillor përmban një kapitull të veçantë kushtuar „Interkulturalizmit në arsim”. Brenda këtij kapitulli është parashikuar që në mënyra të ndryshme të sigurohet interkulturalizmi në arsim. Një nga mënyrat realizohet përmes futjes së përmbajtjeve multikulturore të cilat promovojnë karakteristikat kulturore të të gjitha bashkësive që jetojnë në vendin tonë dhe/ose dëshmojnë për ndërveprimin mes anëtarëve të këtyre bashkësive. Përmbajtje të tilla janë të pranishme në programet mësimore në të gjitha lëndët, çdo herë kur kjo është e mundur, që detyrimisht pasqyrohet në librat dhe materialet shkollore për këto lëndë. Forcimi i interkulturalizmit parashikohet përmes organizimit të aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore me grupe “të përziera” të nxënësve që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore. Aktivitete të tilla janë shumë të rëndësishme për sigurimin e ndërveprimit mes nxënësve që nuk kanë mundësi tjetër të kontaktojnë dhe të bashkëpunojnë gjatë arsimit formal.

Dokumentet që mundësojnë përforcimin e kapaciteteve të mësimdhënësve, kuadrit profesional dhe udhëheqës në fushën e integrimin ndëretnik dhe interkulturalizmit dhe që japin një bazë të mirë për realizimin e suksesshëm të orëve të përbashkëta mësimore janë:

- ✓ Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e programit zhvillimor dhe vjetor për punë në shkollat fillore²⁰;

²⁰ <https://mon.gov.mk/content/?id=3297>

- ✓ Rregullorja për kompetencat themelore të arsimtarëve në shkolla fillore dhe të mesme sipas fushave²¹;
- ✓ Rregullorja për kompetencat themelore profesionale të bashkëpunëtorëve profesional në shkolla fillore dhe të mesme sipas fushave²²;
- ✓ Rregullorja për standardet profesionale për titujt arsimtarë-mentor dhe arsimtarë-këshilltar dhe mënyra e përvetësimit²³
- ✓ Rregullorja për standardet profesionale për titujt bashkëpunëtorë profesional-mentor dhe bashkëpunëtorë profesional-këshilltar dhe mënyra e përvetësimit²⁴
- ✓ Rregullorja për standarde për avancim në tituj²⁵
- ✓ Rregullorja për formën, përmbajtjen dhe elementet e Programit për mbështetjen e fillestarit dhe Raporti për zotërimin e kompetencave themelore profesionale dhe gatishmërinë e tij/saj për dhënien e provimit profesional²⁶;
- ✓ Rregullorja për kompetenca profesionale për drejtor të shkollës fillore²⁷;
- ✓ Treguesit për cilësinë e punës së shkollave²⁸;
- ✓ Programi për trajnim dhe provim të drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme²⁹.



5. PËRFITIMET NGA REALIZIMI I ORËVE TË PËRBASHKËTA

Përfitimet për nxënësit

Përvojat e deritanishme kanë treguar se zhvillimi i kompetencave interkulturore ndihmon nxënësit të bëhen më empatik, më fleksibil dhe tolerantë. Programet për integrim ndëretnik të nxënësve përmes orëve të përbashkëta mësimore i mundësojnë nxënësit të përdorin mundësitë që ofron diversiteti dhe të mësojnë si të komunikojnë, të bashkëpunojnë për interesa të përbashkëta në një botë të larmishme dhe sfiduese.

Nxënia interkulturore mundëson edhe një mjedis mësimor më kreativ dhe të shëndetshëm ku nxënësit mësojnë si t'i pranojnë dhe t'i respektojnë dallimet, të

21 https://mon.gov.mk/stored/document/06_Pravilnik-za-osnovni-profesionalni-kompetencii-za-nastavnici_18_02_20...pdf

22 https://mon.gov.mk/stored/document/07_Pravilnik-za-osnovni_kompetencii_strucen_sorabotnik_13_02_2020.pdf

23 <https://mon.gov.mk/stored/document/pravilnik-profesionalni-standardi-za-nastavnici-1.pdf>

24 <https://mon.gov.mk/stored/document/pravilnik-za-profesionalni-standardi-za-strucni-sorabotnici.pdf>

25 https://mon.gov.mk/stored/document/Pravilnik%20za%20standardi%20za%20napreduvanje%20vo%20zvanje_5.10.2020.pdf

26 <https://mon.gov.mk/stored/document/Pravilnik%20za%20formati%20sodrznata%20i%20elementite%20na%20Programata%20i%20izvestajot-%20pripravnik.pdf>

27 <https://mon.gov.mk/stored/document/Pravilnik%20za%20profesionalni%20kompetencii%20za%20direktor%20na%20osnovno%20uciliste.pdf>

28 https://www.britishcouncil.mk/sites/default/files/priracnik_ikru-mk.pdf

29 <https://dic.edu.mk/wp-content/uploads/2018/09/Programa-za-osnovna-obuka-na-direktori.pdf>

punojnë dhe t'i mbështesin bashkënxënësit që janë të ndryshëm nga ata. Në këto orë nxënësit po ashtu mësojnë për veten dhe kulturën e tyre, si hap i parë i të kuptuarit të kompleksitetit kulturor. Përfitimet e nxënësve nga orët e përbashkëta konkretisht janë:

- ✓ zhvillimi i vlerave qytetare dhe demokratike dhe bashkëpunimi për çështjet e rëndësishme për nxënësit
- ✓ zvogëlimi i paragjykimëve etnike/kulturore dhe respektimi i diversitetit
- ✓ tejkalimi i stereotipeve
- ✓ forcimi i vetëbesimit dhe besimit të tjerët, të ndryshëm nga ai/ajo
- ✓ kohezioni dhe sinergjia mes të rinjve
- ✓ mundësi për të mësuar gjuhën e "tjetrit".

Përfitimet për mësimdhënësit

Mësimdhënësit, për të realizuar mësim në klasë me grup të përzier nxënësish, duhet të përgatiten për sfidat e këtij lloji mësimdhënieje. Kjo do të thotë zhvillimin e kompetencave personale, pikë së pari të kuptuarit e kulturës së cilës i përkasin nxënësit dhe ata vetë. Mësimdhënësit kompetentë janë më efikas në ndërtimin e klasave inkluzive dhe në punë me nxënës të kulturave dhe përkatësive të ndryshme etnike, si dhe me mësimdhënës të tjerë me prejardhje të ndryshme kulturore në shkollën e tyre, dhe të shkollave tjera partnere, etj. Sendërtimi, kujdesi dhe ndërtimi i vlerave interkulturore i ndihmon mësimdhënësit të planifikojnë dhe të zbatojnë projekte interkulturore interesante dhe të kenë ndikim më të thellë dhe gjithëpërfshirës në bashkësitë e tyre lokale. Nisur nga këtu, përfitimet për mësimdhënësit janë:

- ✓ arritja e kompetencave themelore profesionale (në fushën e interkulturës) dhe standardeve për titull më të lartë (mentor dhe/ose këshilltar)
- ✓ bashkëpunim dhe kohezion më i madh, ngritje kapacitetesh, të nxënësve nga njëri-tjetri (shkëmbim përvojash) përmes:
 - planifikimit të përbashkët të mësimdhënies
 - shkëmbimit të materialeve mësimore
 - përgatitjes së përbashkët të instrumenteve për vlerësim
 - shkëmbimit të përvojave nga pjesëmarrja e përbashkët në trajnime dhe aktive profesionale
 - vizitave të ndërsjella të aktiviteteve dhe orëve të përbashkët mësimore
 - përforcimit të besimit dhe respektit ndaj të tjerëve (kolegëve, mësimdhënësve, nxënësve, prindërve).

Përfitimet për shkollën

Orët e përbashkëta i mundësojnë trupat shkollorë të jenë më bashkëpunues gjatë funksionimit të tyre në shkollë, veçanërisht kur në atë shkollë realizohet mësim në dy ose më shumë gjuhë, ata përforcojnë frymën e bashkëpunimit dhe harmonisë në shkollë dhe

me shkollat e tjera. Në shkolla, pjesëmarrësit e kulturave të ndryshme komunikojnë dhe mësojnë nga njëri-tjetri, mësimdhënësit dhe nxënësit e pranojnë nxënien interkulturore si pjesë e punës së tyre, kurse shkolla kujdeset për interkulturalizmin si vlerë kulmore.

Në mënyrë të drejtpërdrejtë mësimdhënësit, po edhe trupat e tjerë në shkollë (këshilli i mësimdhënësve, kuvendi i nxënësve, aktivi i mësimdhënësve, këshilli i prindërve, etj.) iu ndihmojnë nxënësve të përdorin atë që është mësuar në shkollë që të nxisin bashkëpunimin me bashkësinë më të gjerë ku ata jetojnë. Kjo do të thotë:

- ✓ *klime pozitive emocionale në drejtim të respektimit të standardeve interkulturore³⁰, e cila reflekton pozitivisht në procesin edukativo-arsimor në shkollë;*
- ✓ *mjedis i sigurt shkollor;*
- ✓ *vendosja e standardeve dhe kriterëve të njëjta në nivel shkolle, pavarësisht nga gjuha mësimore;*
- ✓ *arritje më të larta arsimore, si rezultat i ndërvarësisë pozitive;*
- ✓ *ngritja e ndjenjës së kolegjalitetit dhe bashkëpunimit mes punonjësve.*

Përfitimet për shoqërinë

Zhvillimi i kompetencave interkulturore të nxënësit në të njëjtën kohë kontribuon për plotësimin e qëllimeve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për krijimin e një shoqërie për të gjithë, ndërsa me të dhe qytetarë të ardhshëm që janë të gatshëm të jetojnë e të avancojnë bashkësinë interkulturore. Pra, kjo do të thotë:

- ✓ *ndërtimi i një shoqërie me vlera demokratike dhe interkulturore, respektimi i diversitetit dhe marrëdhënie të avancuara ndëretnike;*
- ✓ *ndërtimi i një shoqërie me ndërvarësi pozitive të zhvilluar të grupeve të ndryshme etnike/kulturore;*
- ✓ *rezultate të larta arsimore në nivel shtetëror;*
- ✓ *arritja e rezultateve të njëjta/të përafërta në nivel shtetëror, në mënyrë të krahasueshme dhe sipas gjuhës mësimore.*

³⁰ <https://www.bro.gov.mk/>



6. ROLI I INSTITUCIONEVE TË TË GJITHA NIVELEVE NË MBËSHTETJE TË ORËVE TË PËRBASHKËTA MËSIMORE

Lidhja funksionale dhe harmonizimi në nivel qendror, lokal dhe në nivel shkolle duke përfshirë trupat profesionalë, organet drejtuese dhe udhëheqësitë e shkollave sigurojnë zbatim të suksesshëm të aktiviteteve të përbashkëta të shkollave, kurse investimi në mësimdhënës kontribuon sidomos për realizim të suksesshëm të orëve të përbashkëta mësimore.

6.1 ROLI I INSTITUCIONEVE NË NIVEL QENDROR

Institucionet në nivel qendror që janë përgjegjëse për planifikimin, ndjekjen dhe/ose evidentimin e aktiviteteve të përbashkëta për integrimin ndëretnik në arsim janë: Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), Byroja e Zhvillimit të Arsimit (BZHA), Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim (QAPT), Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA), Qendra Shtetërore e Provimeve (QSHP) dhe Komisioni për forcimin e kapaciteteve për avancimin e integritimit ndëretnik në arsim.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka vizion për të promovuar vlerat dhe themelet e arsimit dhe shkencës cilësore, si çelës për përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë në tërësi. Roli i MASH-it është të sigurojë të gjitha kushtet ligjore, administrative dhe strategjike dhe kornizat për zhvillimin pa pengesë të orëve të përbashkëta në shkollë.

Komisioni për forcimin e kapaciteteve për avancimin e integritimit ndëretnik në arsim³¹ – i formuar brenda MASH-it, ndjek përmbushjen e Planit për matjen e arritjeve (PMA), i cili është një mjet për matjen e arritjeve në procesin e sigurimit të kohezionit ndëretnik në sistemin arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga të dhënat e mbledhura nga institucionet relevante si BZHA-ja, QAPT-ja, QSHP-ja dhe ISHA-ja për aktivitetet e zbatuara të integritimit ndëretnik, po ashtu dhe nga të dhënat e mbledhura për aktivitete të caktuara, si në mësimin e detyruar, ashtu edhe në aktivitetet jashtëmësimore në shkollat fillore e të mesme. Rezultatet përfaqësojnë bazë për përcaktimin e prioriteteve nacionale dhe për planifikimin e aktiviteteve të radhës..

Byroja e Zhvillimit të Arsimit dhe Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim japin drejtime/udhëzime për zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të përbashkëta

31 I themeluar nga përfaqësues të MASH, BZHA, QAPT, ISHA, QSHP, Bashkësia e Njësisë të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL) dhe Drejtoria e Avancimit të Gjuhëve të Bashkësive në kuadër të Ministrisë së Sistemit Informatik.

mësimore, përshkruajnë kriteret për realizim dhe instrumentet për ndjekjen e zbatimit të aktiviteteve/orëve të përbashkëta mësimore, sigurojnë zhvillim profesional dhe literaturë profesionale, ndjekin dhe mentorojnë orët/aktivitetet, japin këshilla për përmirësim, bëjnë evidentime, përpilojnë analiza të aktiviteteve/orëve të zbatuara dhe në përputhje me analizat, japin propozime për përmirësimin e realizimit të aktiviteteve të përbashkëta. BZHA-ja dhe QAPT-ja me programin vjetor të punës planifikojnë ndjekjen e zbatimit të orëve të përbashkëta dhe dhënien e këshillave mësimdhënësve, dhe organizojnë trajnime shtesë në përputhje me nevojat e identifikuar.

Ndjekja dhe mbështetja nga institucionet (BZHA dhe QAPT)

Me qëllim përmirësimin e cilësisë së realizimit dhe motivimin e mësimdhënësve që zbatojnë orë të përbashkëta, këshilltarët e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit dhe Qendrës për Arsim Profesional dhe Trajnim ndjekin realizimin e orëve të përbashkëta. Duke u nisur nga përgjegjësitë këshilluese-konsultative dhe mentoruese-udhëzuese të institucioneve, këshilltari përkatës merr pjesë gjatë përgatitjes dhe gjatë realizimit të disa prej orëve të përbashkëta mësimore dhe diskuton me mësimdhënësit pas mbajtjes së orëve të përbashkëta.

Gjatë ndjekjes së orës mësimore, këshilltari bën vlerësimin e orës sipas instrumentit të caktuar për ndjekjeje, si pjesë e dokumentit „Raporti për realizimin e orëve të përbashkëta”, gjersa pas realizimit të orës së përbashkët, këshilltari jep këshilla për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe përpilon *Raportin për ndjekjen e orëve të përbashkëta*. (shtojca nr.1).

Inspektorati Shtetëror i Arsimit – përmes vlerësimit integral bën vlerësimin e zbatimit të aktiviteteve për integrim ndëretnik dhe orëve të përbashkëta dhe i publikon në raportin vjetor për cilësinë e procesit edukativo-arsimor në institucionet edukative-arsimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

6.2 ROLI I KOMUNAVE DHE QYTETIT TË SHKUPIT

6.2.1 Roli i komunës në mbështetje të aktiviteteve të përbashkëta

Komunat dhe Qyteti i Shkupit në kuadër të përgjegjësive të tyre ligjore kanë detyrime që të ofrojnë kushte për arsimin e integruar, bazuar në parimet demokratike, që do t'i përgatitë nxënësit për jetë në një shoqëri multietnike përmes njohurive të fituara nga përvoja, kompetencave dhe vlerave që promovojnë solidaritetin, barazinë, bashkëpunimin me të gjithë anëtarët e bashkësisë shoqërore.

Në bazë të Ligjit të vetëqeverisjes lokale, çdo komunë dhe Qyteti i Shkupit ka mundësi të përgatisë dokumentet programore dhe strategjike vetanake përmes të cilave forcon rolin e saj në krijimin dhe zbatimin e politikave në përputhje me nevojat lokale dhe vizionet e zhvillimit të arsim dhe bashkësisë në tërësi. Nga këtu, secila komunë e

cila synon të promovojë integrimin ndëretnik në arsim, është e patjetërsueshme t'i shndërrojë politikat e saj arsimore në aktivitete dhe detyra konkrete në kuadër të:

- ▶ Dokumenteve strategjike shumëvjeçare për avancimin e integritit ndëretnik, të cilat do të sigurojnë vazhdimësi dhe zhvillim të politikave të sjella; dhe;
- ▶ Programeve vjetore të punës në fushën e arsimit.

6.2.1.1 Sigurimi i mbështetjes financiare për zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta mësimore

Për aplikimin e suksesshëm të politikave të saj arsimore bazuar në dokumentet programore strategjike është e nevojshme që komuna dhe Qyteti i Shkupit të sigurojë burime financiare nga fondet e veta, të buxhetit njëvjeçar po ashtu edhe shumëvjeçar. Mbështetja financiare për realizimin e orëve të përbashkëta dhe të formave të tjera të bashkëpunimit dhe lidhjeve ndëretnike sigurohet në mënyrat e mëposhtme:

- ▶ në kuadër të buxhetit bazë të komunave dhe Qytetit të Shkupit;
- ▶ përmes shpërndarjes së bllok-dotacioneve për shkollat; dhe
- ▶ nëpërmjet sigurimit të donacioneve, granteve, etj.

Programimi dhe buxhetimi janë procese të cilat bëhen paralelisht nëpërmjet mekanizmave të vendosur dhe procedurave ligjore.

Çfarë në fakt duhet të planifikohet në kuadër të proceseve të programimit dhe buxhetimit të aktiviteteve të përbashkëta mësimore?

- ▶ Orët e përbashkëta duhet të jenë pjesë e dokumenteve programore të komunave dhe Qytetit të Shkupit nga njëra anë, por në të njëjtën kohë duhet të pasqyrohen dhe në programin vjetor të punës së shkollës, ndërsa më pas edhe në organizimin e procesit mësimor në shkollë;
- ▶ Komunitat dhe Qyteti i Shkupit kanë rol në planifikimin e mjeteve financiare në zërat përkatës në buxhetin e tyre themelor për të mbështetur procesin e realizimit dhe promovimit të orëve të përbashkëta në shkolla. Ajo kryen dhe shpërndarjen e mjeteve nga bllok-dotacionet në shkolla, të cilat i transferon pushteti qendror. Komunitat dhe Qyteti i Shkupit kanë mundësi, në mënyrë të pavarur ose me shkollat, të aplikojë tek fondacionet ose organizatat vendore dhe ndërkombëtare etj. për marrjen e donacioneve dhe granteve për zbatimin e orëve të përbashkëta.

6.2.2. Aktivitetet e komunave dhe Qytetit të Shkupit në procesin e zbatimit të orëve të përbashkëta mësimore

Fazat e realizimit të orëve të përbashkëta mësimore:

- ✓ Faza përgatitore – periudha para fillimit të vitit shkollor;
- ✓ Faza e zbatimit – gjatë vitit shkollor;
- ✓ Faza e ndjekjes dhe vlerësimit – nga fillimi i aktiviteteve si proces vlerësimi dhe pas mbarimit të tyre, në fund të vitit shkollor kur vlerësohen rezultatet nga zbatimi.

Faza përgatitore duhet të mbulojë periudhën para fillimit të vitit shkollor. Zakonisht duhet të fillojë me takimin mes personave përgjegjës për arsim në komunë, drejtorëve dhe koordinatorëve të ekipeve për integrim shkollor (EISH) në shkollat në të cilat do të realizohen orë të përbashkëta mësimore. Pastaj vijnë aktivitetet të cilat zhvillohen në shkolla, pra në konsultim dhe koordinim të vazhdueshëm mes përfaqësuesve të komunës, drejtorëve të shkollave dhe koordinatorëve të EISH zgjedhen lëndët që do të mësohen së bashku, paralelet dhe mësimdhënësit të cilët do zbatojnë orët e përbashkëta, vendosen planet dhe dinamika e mbajtjes së orëve të përbashkëta, bëhen bisedime dhe promovime para këshillave të shkollave, këshillave të prindërve, si dhe shumë aktiviteteve të tjera.

Faza e zbatimit zgjat më shumë, pra gjatë gjithë muajve të mësimdhënies. Në këtë fazë roli i komunave dhe Qytetit të Shkupit është të ofroj mbështetje aktive në të gjitha aspektet e zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta mësimore përmes takimeve të rregullta dhe mbledhjeve konsultative me drejtorin/drejtoreshën dhe koordinatorin/koordinatoren e EISH për të zbuluar problemet dhe mënyrat e tejkalimit të tyre.

Faza e ndjekjes dhe vlerësimit, në përgjithësi zbatohet pas mbarimit të vitit mësimor, por ekzistojnë dhe aktivitetet për ndjekjen procesore dhe për vlerësim të aplikimit të orëve të përbashkëta gjatë gjithë vitit shkollor. Për të kryer vlerësimin përdoren pyetësorë dhe anketa përkatëse për të mbledhur të dhëna për shkallën e përfundimit të bashkëveprimit mes nxënësve dhe mësimdhënësve, për kënaqësinë e tyre gjatë pjesëmarrjes në orë të tilla, po ashtu edhe të dhëna për shkallën e njohurive të fituara përmes notave të lëndëve, të dhëna për përmirësimin e kompetencave të mësimdhënësve përmes punës dhe bashkëpunimit kolegjal. Komuna dhe shkollat duhet të inkuadrojnë të dhënat e fituara në politikat dhe strategjitë e tyre të ardhshme për avancimin e integritimit ndëretnik, si parametër objektiv për planifikimin e jetës reale interkulturore në shkolla.

Në shtojcën numër 2 është dhënë një pasqyrim i gjerë i *rolit specifik të komunave dhe Qytetit të Shkupi në organizimin e orëve të përbashkëta mësimore*.

6.3. ROLI I SHKOLLËS

Për zbatimin *e orëve dhe/ose aktiviteteve të përbashkëta mësimore* në shkollë është i nevojshëm angazhimi i të gjitha subjekteve në shkollë që janë përgjegjës në mënyrë direkte ose indirekte për zbatimin e suksesshëm të orëve/aktiviteteve të përbashkëta, si më poshtë: udhëheqësia e shkollës, ekipi për integrim shkollor dhe mësimdhënësit realizues. Aktivitetet të cilat zbatohen kanë të bëjnë me aktivitetet në nivel shkollor dhe me aktivitetet e mësimdhënësve.

6.3.1. Aktivitet në nivel shkollor

Planifikimi i orëve mësimore dhe/ose aktiviteteve të përbashkëta në shkollë kryhet para fillimit të mësimit në vitin shkollor. Drejtori/drejtoresha, së bashku me ekipin për integrim shkollor, varësisht nga numri i paraleleve sipas gjuhës mësimore dhe viteve mësimore, si dhe numri i nxënësve në paralele, bën listën e mësimdhënësve kompetentë (që kanë qenë pjesë e trajnimeve përkatëse) për mbajtjen e orëve të përbashkëta. Në nivel shkollor merret vendimi cilat lëndë të detyrueshme, apo lëndë zgjedhore, do të ligjërohen në paralele të “përziera”, dhe a do të përgatitet dhe zbatohet programi i përbashkët për përmbajtjet e programuara nga shkollat (në shkollat profesionale).

Aktivitetet e përbashkëta planifikohen në programin vjetor të punës së shkollës, i cili është i ndryshëm në shkolla të ndryshme (shkolla fillore, të mesme/profesionale), që t’iu përshtatet kushteve dhe nevojave të nxënësve. Ato janë pjesë e misionit dhe vizionit të shkollës, pjesë e politikave shkollore dhe e planit të aktiviteteve. Si bazë në procesin e planifikimit të shkollës janë rezultatet e vetëvlerësimit për të graduar ku është pozicionuar shkolla në atë moment sa i takon kësaj çështjeje.

Gjatë planifikimit të orëve të përbashkëta dhe planifikimit të aktiviteteve interkulturore duhet të respektohen parime të caktuara të paraqitura në shtojcën 1.

6.3.1.1 Orët e përbashkëta në lëndët e detyrueshme mësimore në arsimin fillor dhe të mesëm

Orët e përbashkëta në kuadër të lëndëve mësimore me status lënde mësimore e detyrueshme mund të mbahen në të gjitha shkollat nëse gjatë realizimit të mësimit përdoren aktivitete që drejtohen drejt nxënësve përmes metodave, teknikave dhe strategjive që mundësojnë ndërveprim mes nxënësve, me theks të veçantë tek lëndët dhe aktivitetet mësimore të cilat përfundojnë me një produkt të përbashkët, si për shembull hulumtim, projektim, prezantim, ekzekutim, etj. Praktika e deritanishme flet për kryerjen me sukses të aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të lëndëve të caktuara mësimore, siç janë arsimit figurativ/art, arsimit muzikor/art dhe arsim shëndetësor/sport dhe aktivitete sportive, gjuhë të huaja dhe lëndë mësimore profesionale të cilat realizohen përmes orëve me mësim teorik dhe ushtrime dhe/ose mësim praktik (në arsimin e mesëm profesional).

Në këtë kontekst është shumë e rëndësishme që gjatë planifikimit të mësimit, mësimdhënësit duhet t’iu përmbahen Standardeve nacionale për arritje të nxënësve në fund të arsimit fillorë të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin e kompetencave interkulturore³² dhe Standardeve për arsim interkulturore³³, e që janë pjesë e programit mësimor për lëndën konkrete mësimore. Në atë drejtim do të mundësohet zhvillimi i kompetencave interkulturore bashkë me zhvillimin e kompetencave për lëndën mësimore konkrete përmes orëve/aktiviteteve të përbashkëta.

³² <https://www.bro.gov.mk/sq/%d0%bd%d0%b0%d1%86%d0%b8%d0%be%d0%bd%d0%b0%d0%bb%d0%bd%d0%b8-%d1%81%d1%82%d0%b0%d0%bd%d0%b4%d0%b0%d1%80%d0%b4%d0%b8-%d0%b7%d0%b0-%d0%bf%d0%be%d1%81%d1%82%d0%b8%d0%b3%d0%b0%d1%9a%d0%b0%d1%82%d0%b0/>

³³ Të miratuara në bazë të Strategjisë për zhvillimin e konceptit për një shoqëri dhe intekulturalizmit https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/strategii/strategija_ednoopshtestvo_29.10.2019.pdf.

6.3.1.2. Lëndët mësimore zgjedhore në arsimin fillor

Në përputhje me Konceptin e arsimit fillor dhe Udhëzuesin për organizimin dhe realizimin e aktiviteteve/lëndëve të zgjedhura të lira në arsimin e fillor³⁴, shkollat realizojnë lëndë zgjedhore të lira në katër kategori:

- (1) lëndë zgjedhore për zgjerimin/thellimin e njohurive për lëndët e detyrueshme mësimore (shembull: gjykimi matematiko-logjik, programimi, pikturimi/vizatimi/ skulpturimi, kultura klasike, edukata seksuale);
- (2) lëndë zgjedhore për mbështetjen e interesave të nxënësve që nuk janë pjesë e lëndëve mësimore (shembull: fotografim, kopshtari/hortikultur, punëtori teatrore, vallëzim, gatim, gdhendari, modelim);
- (3) lëndë zgjedhore për mbështetjen e zhvillimit personal dhe social të nxënësve (shembull: arsimi për shkathtësitë jetësore, punëtori multikuturore);
- (4) lëndët zgjedhore me karakter sportivo-rekreativ (shembull: futboll, basketbolli, hendbolli, volejbolli, ping-pongu, joga, pilatesi).

Shkolla duhet të përpiqet të ofrojë lëndë zgjedhore përmes të cilave do të nxisë zhvillimin e kompetencave interkulturore, siç janë lëndët e kategorisë së tretë, të cilat përfshijnë përmbajtje multikulturore që sigurojnë njohuri për dallimet dhe ngjashmëritë në kulturat e bashkësive të ndryshme etnike që jetojnë në vendin tonë, ose që sigurojnë ndërveprim mes nxënësve që mësojnë në një gjuhë mësimore me nxënësit e tjerë që mësojnë në një gjuhë tjetër mësimore përbrenda kategorive të tjera të lëndëve të lira zgjedhore, kurse planifikimi parashikon zhvillimin e aktiviteteve në orë në të dy gjuhët mësimore.

6.3.1.3. Orët e lira në shkollat/përmbajtjet e programuara nga shkollat e arsimit profesional

Në përputhje me Konceptin për modernizim të arsimit teknik, planifikohen përmbajtje të programuara nga shkolla (më herët njiheshin si orë të lira në shkollë), funksioni i të cilave është të plotësojë nevojat më të gjera të nxënësve të cilët mund të zgjedhin dhe përmbajtje të tjera jashtë përmbajtjeve të planifikuara në lëndët zgjedhore dhe të detyrueshme. Gjithashtu ata mund të angazhohen që përmes këtyre përmbajtjeve të përfshihen në aktivitetet që i organizon bashkësia lokale ose të bashkëpunojnë me partnerët përkatës social, në mënyrë që të plotësohen më tej kompetencat kyçe dhe profesionale, që të integrohen më mirë në tregun e punës dhe të planifikojnë më mirë karrierën e tyre.

Këto orë mund t'i planifikojë shkolla, në mënyrë që të mbahen në grupe të përziera nxënësish duke respektuar kriteret për orë të përbashkëta.

³⁴ <https://www.bro.gov.mk/%D0%B2%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D1%87-%D0%B7%D0%B0-%D1%81%D0%BB%D0%BE%D0%B1%D0%BE%D0%B4%D0%BD%D0%B8-%D0%B8%D0%B7%D0%B1%D0%BE%D1%80%D0%BD%D0%B8-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%BC%D0%B5%D1%82%D0%B8-%D0%B7%D0%B0/>

Gjatë marrjes së vendimit në nivel shkollor se cilat paralele [cilat lëndë të detyrueshme](#), [cilat lëndë zgjedhore](#) (në shkollat fillore) ose [përmbajtje të programuara të shkollës](#) (në arsimin profesional) dhe cilët mësimdhënës do të mbajnë orë të përbashkëta, duhet të respektohen këto parime:

- ✓ për mbajtjen e orëve të përbashkëta mësimore duhet të respektohen kriteret e orëve të përbashkëta (të renditura në tabelën 1);
- ✓ në qoftë se realizohen orë të përbashkëta në distancë (onlajn), respektohen drejtimitet e dhëna në dokumentin [Udhëzues për metodikën e mësimit në distancë në arsimin fillor dhe të mesëm](#)³⁵.

Tabela 1. Kriteret për realizimin e orëve të përbashkëta

- ▶ Balancimi i numrit të nxënësve sipas gjuhës mësimore. Me balancimin e numrit të nxënësve të paraleleve me gjuhë mësimore të ndryshme sigurohet drejtësi, besim, relaksim, siguri më e madhe të nxënësit dhe mundësi të barabarta për përfaqësimin e të dyja gjuhëve gjatë orës mësimore.
- ▶ Orët e përbashkëta planifikohen dhe realizohen vetëm mes dy paraleleve, ku numri i nxënësve në një paralele nuk është më i madh se përafërsisht 20% të numrit të nxënësve në paralelen tjetër.
- ▶ Orët e përbashkëta mbahen nga dy mësimdhënës, të cilët mësimin e ligjërojnë në dy gjuhë mësimore të ndryshme që përfaqësohen në mënyrë të barabartë.
- ▶ Kur mësimi i rregullt me prezencë fizike në shkollë zhvillohet në dy turne (ndërrime) të ndryshme të ndara sipas gjuhës mësimore, orët e përbashkëta organizohen/mbahen mes turneve (ndërrimeve) dhe kjo evidentohet në orarin e shkollës.
- ▶ Në raste ku mësimi i rregullt zhvillohet në dy objekte të ndryshme shkollore ose mes shkollave partnere, orët e përbashkëta mësimore me pjesëmarrje fizike planifikohen dhe mbahen me radhë, duke alternuar në të dy objektet. Në këtë rast, orët e përbashkëta mësimore mund të realizohen edhe në distancë (onlajn).

6.3.2. Planifikimi i orëve të përbashkëta

Planifikimi i mësimdhënies të lëndëve zgjedhore dhe/ose të detyrueshme nga mësimdhënësit realizues është një parakusht për cilësinë, organizimin, përgatitjen efikase dhe të suksesshme, organizimin dhe realizimin e mësimit bazuar në planin dhe programin mësimor. Planifikimi merr parasysh karakteristikat e nxënësve, si: moshën e tyre, njohuritë paraprake, nevojat, mundësitë dhe aftësitë, por poashtu edhe kushtet dhe materialet e punës që janë në dispozicion të mësimdhënësit/mësimdhënëses d.m.th të shkollave. Gjatë planifikimit, mësimdhënësit udhëhiqen nga kompetencat që dalin nga standardet nacionale dhe rezultatet e përcaktuara të nxënies, si dhe standardet për notim të shënuara në programin mësimor për lëndën konkrete.

³⁵ <https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2021/03/Upatstvo-za-metodika-za-nastava-na-dalecina-1.pdf>

Sipas llojeve të formave të planifikimit dhe shkallës së arsimit, mësimdhënësit përgatisin:

Në arsimin fillor³⁶:

- ▶ planifikimin tematik
- ▶ planifikimin javor
- ▶ planifikimin për orë /skenarin për orë

Në arsimin e mesëm:

- ▶ planifikimin global/vjetor
- ▶ planifikimin e njësisë modulare/planifikimin tematik
- ▶ planifikimin e orës mësimore

6.3.2.1. Llojet e planifikimit të orës së përbashkëta (për lëndët e detyrueshme, për lëndët zgjedhore dhe planifikimi i lirë, për aktivitet/lëndë zgjedhore)

Planifikimi vjetor përgatitet para fillimit të vitit shkollor (në arsimin e mesëm). Për të siguruar realizimin e sinkronizuar dhe me kuptim të programit mësimor, planifikimin e përbashkët e bëjnë dy mësimdhënësit.

Mësimdhënësit duhet:

- ✓ të analizojnë programin mësimor për lëndën mësimore që do të ligjërojnë bashkë;
- ✓ të kryejnë përpunimin global të përmbajtjeve programore dhe përcaktimin e fondit të orëve për secilën njësi modulare/temë mësimore veç e veç për të dy gjysmëvjetorët;
- ✓ të përcaktojnë njësitë tematike/njësitë modulare dhe/ose përmbajtjet mësimore që mund t'i realizojnë së bashku me sukses;
- ✓ të përcaktojnë temat/fushën/njësitë modulare, me theks te përcaktimi i njësive tematike/njësive modulare/ përmbajtjeve në të cilat mund të përfshihen kompetencat interkulturore;
- ✓ të analizojnë materialet dhe resurset në dispozicion, dhe të bëjnë zgjedhjen e tyre, përfshirë resurset digjitale të cilat janë veçanërisht të nevojshme për mësimin në distancë;
- ✓ bëjnë kujdes që përfaqësimi i orëve të përbashkëta në raport me numrin e përgjithshëm të orëve vjetore për lëndën mësimore të mos jetë më pak se 50%.

Planifikimi tematik/njësia modulare, si rregull, duhet të përgatitet më së voni 10 ditë para fillimit të përpunimit të temës së parashikuar/njësisë modulare. Planifikimi i njësisë modulare/planifikimi tematik duhet të jetë në korrelacion me programin mësimor për lëndën konkrete, pra me planifikimin vjetor. Për të pasur plan të suksesshëm dhe cilësor

³⁶ Ky lloj planifikimi realizohet në përputhje me udhëzimet e dhëna në Konceptin e ri për arsimin fillor, kurse vitet tjera vazhdojnë në përputhje me mënyrën ekzistuese të planifikimit deri në prezantimin e programeve të reja mësimore.

të njësisë modulare/planifikimit tematik, më parë duhet të bëhet përgatitja paraprake, përmes aktiviteteve të përbashkëta të mësimdhënësve, si më poshtë:

- ✓ studimi i njësisë modulare/ temës/fushës që do realizohet bashkërisht;
- ✓ identifikimi i kompetencave interkulturore transversale³⁷ që mund të zhvillohen në kuadër të temës;
- ✓ përcaktimi i aktiviteteve që mund të punohen përmes projekteve me afat më të gjatë ose më shkurt, përmes hulumtimeve ose sipas dinamikës individuale;
- ✓ gjatë përcaktimit të aktiviteteve të merret parasysh zhvillimi i kompetencave interkulturore;
- ✓ përcaktimi i formave, metodave, teknikave dhe strategjive për arritjen e rezultateve nga nxënia dhe standardet për notimin e përparimit të nxënësit/nxënësës;
- ✓ përcaktimi i qasjes në punë për sigurimin e zbatimit bilingual (dygjuhësh) të orës/aktivitetit;
- ✓ sigurimi i resurseve dhe materialeve, përfshirë resurset digjitale edhe nga aspekti i promovimit të integritetit multikulturor, barazisë (sipas përkatësisë etnike, gjinore, fetare);
- ✓ ndjekja dhe kontrollimi i arritjeve të nxënësve (treguesit/kriteret për vlerësim në përputhje me rezultatet e lëndës mësimore konkrete dhe kompetencat interkulturore tranversale).

Planifikimi javor është karakteristik për arsimin fillor dhe përgatitet nga aktivi i mësimdhënësve të lëndës konkrete, me praninë e detyrueshme të mësimdhënësve që do të mbajnë orën e përbashkët.

Funksioni i këtij lloji planifikimi është informimi i prindërve për standardet e notimit që do të bëhet në fund të javës dhe në kontekst të këtij udhëzuesi, si dhe për kompetencat interkulturore që do të zhvillohen tek nxënësit. Po ashtu, në kuadër të formularit për këtë planifikim të publikuar në faqen e internetit të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, mësimdhënësit plotësojnë edhe pjesën e refleksionit, që mundëson fleksibilitet dhe përshtatjen e skenarit të orës.

Planifikimi i orës/skenari i orës rrjedh nga planifikimi tematik/planifikimi modular, me ç'rast mësimdhënësit konkretizojnë aktivitetet, pra format dhe metodat e punës për arritjen e standardeve të notimit dhe zhvillimin e kompetencave të nevojshme për lëndën konkrete, por dhe njohuritë transversale, shkathtësitë dhe vlerat nga fusha e interkulturalizmit. Në njësinë kohore të një ore mësimore, mësimdhënësi/mësimdhënësja duhet të planifikojë si vijon:

- ✓ rezultatet nga ora mësimore nga lënda konkrete mësimore dhe kompetencat transversale (interkulturore);
- ✓ aktivitetet për arritjen e standardeve të vlerësimit për lëndën dhe zhvillimin e kompetencave interkulturore;

³⁷ <https://www.bro.gov.mk/>

- ✓ materialet dhe mjetet didaktike (të përshtatshme për zhvillimin e kompetencave interkulturore);
- ✓ metodat dhe format e punës për fitimin e njohurive funksionale të përhershme, shkathtësive dhe kompetencave interkulturore (puna në grupe dhe me çifte nxënësish nga paralele të ndryshme);
- ✓ metodat, procedurat për kontrollimin e arritjeve të nxënësve sipas standardeve të notimit dhe për kontrollimin e zhvillimit të kompetencave interkulturore.

Gjatë planifikimit të orëve mësimore mësimeve duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë:

- ▶ përmbajtjes, por edhe procesit;
- ▶ marrëveshjes dhe respektimit të rregullave që vlejné në klasën e përbashkët;
- ▶ planifikimit për mënyrën e mësimeve dhe dhënies së instruksioneve në dy gjuhë të ndryshme;
- ▶ zgjedhjes së metodës së punës në grupe më të vogla;
- ▶ detektimit të asaj që është e përbashkët dhe që u përket nxënësve të të dyja gjuhëve mësimore (kultura, gjuha, historia, etj.);
- ▶ inkurajimit të nxënësve të shprehen lirishëm dhe të flasin në gjuhën që e flasin më së miri;
- ▶ ndërveprimit maksimal të nxënësve;
- ▶ planifikimit dhe përdorimit të qasjes përkatëse individuale dhe të diferencuar gjatë mësimeve;
- ▶ marrëveshjes se si do të sillen në orë në rast të situatave eventuale të paparashikuara.

6.3.2.2. Aktivitetet (format, metodat dhe teknikat) që planifikohen dhe përdoren në organizimin dhe realizimin e mësimit për zhvillimin e kompetencave interkulturore tek nxënësit

Për të arritur ndryshimet reale në qëndrimet, njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e nxënësve, pra zhvillimin e kompetencave interkulturore, qasja më e përshtatshme pedagogjike është të mësuarit përmes përvojës ose të mësuarit përmes punës. Kjo qasje përfshin përvojën, krahasimin, analizën, refleksionin, pra punën kooperative/të përbashkët dhe punën në projekt.

Përdorimi i metodave dhe teknikave që i inkurajojnë nxënësit të përfshihen në mënyrëaktive në fitimin e përvojës, zbulim/hulumtim, analizë, krahasim dhe bashkëpunim është shumë efikase, sepse angazhojnë nxënësit dhe ndikojnë në potencialin e tyre intelektual, fizik dhe emocional. Qasja e tillë e nxënies dhe mësimeve promovon zhvillimin e kompetencave interkulturore pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për lëndë mësimore me status lënde të detyrueshme ose lënde zgjedhore.

Gjatë nxënies kooperative/të përbashkët ose punës në ekip/grup, nxënësit janë individualisht përgjegjës për nxënien e tyre, por gjithashtu edhe për punën në grup. Puna në ekip garanton bashkëpunim mes anëtarëve të grupit, duke çuar në përmirësimin e aftësive shoqërore.

Për të krijuar një mjedis me klimë pozitive për punën e përbashkët ose punën në grupe, nxënësit duhet të ndihen të sigurt dhe të rehatshëm. Metodrat dhe aktivitetet që ndihmojnë në zhvillimin e kompetencave interkulturore duhet të jenë të qarta, në mënyrë që nxënësit të ndihen se janë të mbështetur dhe të motivuar që të punojnë bashkërisht. Për të qenë efikas, nxënësit që janë të përfshirë në detyrat e përbashkëta/grupore duhet të jenë të respektuar, të vëmendshëm, të sqartë dhe empatikë.

Këto janë metodrat që mund të përdoren për zhvillimin e kompetencave interkulturore për të gjithë:

- ▶ nxënie hulumtuese me qëllim motivimin e nxënësit/nxënësës dhe rritjen e ndjenjës së përgjegjësisë për rezultatet e procesit personal të nxënies;
- ▶ nxënie e orientuar drejt projekteve (zhvillimi i strategjive për negociimi për diversitetin dhe dallimin, ashtu siç është zhvillimi i aftësive specifike për tejkalimin e barrierave gjuhësore në mjedisin interkulturor që janë të nevojshme për ndërveprim dhe negociata);
- ▶ nxënie për bashkëpunim me grupe dhe ekipe (të bashkëpunojmë njëri me tjetrin, për shembull, përmes ndihmës reciproke ku të gjithë kontribuojnë me anët e tyre "të forta");
- ▶ nxënia përmes diskutimit për pozicionet dhe qëndrimet;
- ▶ luajtja e roleve (marrja dhe eksperimentimi me pozicione të reja në konflikte, si mjet për ngritjen e vetëdijes dhe për zhvillimin e distancimit dhe empatisë për rolet);
- ▶ përdorimi i teksteve të konceptuara (si tregime, përralla, poezi) me aspekte interkulturore, të cilat stimulojnë krijimin e botës së përkohshme ose krijimin e teksteve të tilla për përballimin simbolik me konflikte.

Arsimi interkulturor „nuk mund të arrihet në shkollë, përmes qasjeve didaktike të ngjashme me atë të kompetencave të lidhura me lëndën mësimore konkrete“. (Këshilli i Evropës 2003:20). Ato zhvillohen duke u bazuar në praktikën direkte dhe eksperiencën personale që kemi kur „jetojmë dhe mësojmë së bashku“ dhe mësojmë të bashkëpunojmë njëri me tjetrin me mirësjellje dhe respekt, empati, sjellje të mira, kujdes dhe qëllime të mira.

Në shtojcë jepen disa lloj aktivitetesh të cilat përdorin metodrat e mësipërme dhe qasjet në punë të cilat potencojnë më shumë perspektiva (shtojca 3).

6.3.3. Organizimi i orëve të përbashkëta mësimore

Ka mënyra të ndryshme të organizimit dhe strukturimit të mësimdhënies, sidomos kur bëhet fjalë për mësimin në dy gjuhë. Duhet të merren parasysh shumë faktorë, si për shembull të detektohet "shkalla" e ndarjes së nxënësve dhe mundësia e bashkëpunimit të tyre dhe ndërveprimi me nxënësit e tjerë. Për shembull, sa dhe cilët nxënës e njohin gjuhën e tjetrit, pastaj ata të vendosen si liderë të grupeve më të vogla, të cilët do të punojnë detyrat e projekteve.

Gjatë organizimit të mësimdhënies është e rëndësishme:

- ▶ përmbajtja të ndahet në pjesë më të vogla dhe përmbajtjet të shfaqen njëpasnjëshëm nga më të thjeshta tek ato më të vështirat;
- ▶ materiali të prezantohet në „racione“ të vogla në të dyja gjuhët, në mënyrë të njëpasnjëshme;
- ▶ është e nevojshme që resurset për nxënie të sigurohen në të dyja gjuhët;
- ▶ koha e mbajtjes së orës mësimore duhet të organizohet mirë (pjesa hyrëse, pjesa kryesore dhe pjesa përfundimtare);
- ▶ mësimdhënësit planifikojnë mirë mënyrën e dhënies së udhëzimeve dhe drejtimeve.

6.3.4. Realizimi i orëve të përbashkëta

Gjatë mbajtjes së orës së përbashkët, mësimdhënësit me sjelljen dhe mënyrën e tyre të komunikimit duhet të kujdesen që të krijojnë një atmosferë relaksuese, që çdo nxënës/nxënëse të ndjehet komod dhe i/e sigurt.

Prezantimi, dhënia e instruksioneve dhe dhënia e informatave kthyesë duhet të ndjekin gjithmonë renditjen si më poshtë: fillon mësimdhënësi/ mësimdhënësja 1 në një gjuhë, jep një informacion. Vazhdon mësimdhënësi/ mësimdhënësja 2 në gjuhën tjetër mësimore, jep informacionin e njëjtë dhe vazhdon me informacione të tjera, pastaj vijon mësimdhënësi 1 me informacione plotësuese të dhëna më parë nga mësimdhënësi 2 dhe me informacione të reja, etj.

Gjatë orës, është e rëndësishme të bëhet kujdes për gjërat e mëposhtme:

- ▶ secili mësimdhënës/secila mësimdhënëse t'i dëgjojë nxënësit në mënyrë aktive;
- ▶ secili mësimdhënës /secila mësimdhënëse t'i inkurajojë të gjithë nxënësit të shprehen lirshëm;
- ▶ mësimdhënësit t'i inkurajojnë të gjithë nxënësit të bashkëpunojnë mes tyre;

- ▶ informacioni i ri nuk duhet gjithmonë të dëgjohej më parë nga nxënësit e njërës gjuhë mësimore;
- ▶ gjatë orës të mos përkthehet, por të parafrazohet;
- ▶ mësimdhënësit duhet të kenë gjithmonë të njëjtën qasje me të gjithë nxënësit dhe të kujdesen për ndërveprime më të mëdha mes nxënësve;
- ▶ detyrat e projektit të punohen në grupe “të përziera” më të vogla nxënësish;
- ▶ mësimdhënësit duhet të kenë gjithmonë të njëjtën qasje me të gjithë nxënësit (kjo vlen njësoj dhe kur nxënësit duhet të lavdërohen ose të japin informacione kthyes);
- ▶ evidentimi i arritjeve të nxënësve bëhet nga dy mësimdhënës së bashku për të gjithë grupin e nxënësve;
- ▶ të arrihen rezultatet e planifikuara nga nxënia/qëllimet e parashikuara të orës mësimore të parapara në programin mësimor.

6.3.5. Realizimi i orëve të përbashkëta në distancë

Mësimdhënia në distancë (onlajn) përdoret edhe në rastet e realizimit të orëve të përbashkëta mësimore. Gjatë mbajtjes së orëve të përbashkëta në distancë përdoren drejtimet e dhëna në [Udhëzuesin për metodikën e mësimin në distancë në arsimin fillor dhe të mesëm](#)³⁸. Në dokument janë dhënë drejtime konkrete për përgatitjen dhe planifikimin e orëve të përbashkëta në distancë, organizimin e orëve të përbashkëta në distancë, mbajtjen e orëve të tilla të përbashkëta, po ashtu procedura për formimin e grupeve të nxënësve për realizimin e orëve të përbashkëta, përmes Platformës kombëtare për arsim në distancë (PKAD) dhe drejtpërdrejt përmes “majkrosoft timsit” (Microsoft Teams).

[Vetëvlerësimin e orëve të përbashkëta mësimore](#) e kryejnë bashkërisht që të dy mësimdhënësit pas mbajtjes së orës së përbashkët mësimore. Vetëvlerësimi, në fakt, është një reflektim i efikasitetit, pra efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së të gjitha aktiviteteve gjatë orës, të cilat janë shfrytëzuar që të arrihen rezultatet e nxënies për lëndën ose për të zhvilluar kompetencat interkulturore. Reflektimi i mundëson mësimdhënësit që të perceptojnë të gjitha vështirësitë që kanë hasur gjatë realizimit të çdo segmenti të mësimimit (nxënies, mësimdhënies dhe notimit) gjatë orëve të veçanta gjatë ditës dhe ti marrin parasysh ato njohuritë gjatë planifikimit për të siguruar tejkalimin e dobësive të mundshme gjatë mësimin. Kjo nënkupton ndryshim edhe në planifikimin e orëve të ardhshme, si për shembull me metoda dhe forma të punës për arritje të një bashkëpunimi dhe ndërveprimi më të madh mes nxënësve, përdorimin e materialeve të ndjeshme nga aspekti i interkulturës.

³⁸ <https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2021/03/Udh%C3%ABzues-p%C3%ABr-metodik%C3%ABn-e-m%C3%ABsimin-n%C3%AB-distanc%C3%AB-n%C3%AB-shkoll%C3%ABn-fillor-dhe-t%C3%AB-mesme-1.pdf>

6.3.6. Vlerësimi i nxënësve sipas zhvillimit të kompetencave interkulturore

Mbajtja e orëve të përbashkëta ka për synim të përforcojë kompetencat interkulturore. Planifikimi dhe zbatimi i aktiviteteve për zhvillimin e kompetencave interkulturore zakonisht shoqërohet me notim. Në kontekstin e këtij dokumenti, notimi është matja ose ndjekja sistematike e nxënësit/nxënësës në raport me shkallën e zotërimit të kompetencave interkulturore.

Notimi shpesh lidhet me testet, por ka edhe shumë lloje instrumentesh të tjera që duhet të përdoren gjatë notimit (si për shembull, portofolet dhe ditarët e nxënësve), i cili mund të zbatohet nga mësimitdhënësit, nga vetë nxënësit (me anë të vetëvlerësimit) ose notimin ta bëjnë bashkënxënësit.

Për shkak se kompetencat interkulturore janë një kombinim i qëndrimeve, të kuptuarit dhe njohurive, shkathtësive dhe aktiviteteve, vlerësimi duhet të përfshijë vlerësimin analitik dhe matës/përshkruar të aktiviteteve të realizuara individualisht ose së bashku me nxënësit e tjerë.

Vlerësimi duhet të sigurojë të dhëna se nxënësit dhe mësimitdhënësit u kushtojnë vëmendje serioze kompetencave interkulturore dhe i përfshijnë ato në planifikimin dhe realizimin e programit mësimor, po ashtu edhe në informacionet kthyesë deri tek nxënësit.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve bëhet në përputhje me kriteret e vendosura për notim nga ana e aktivitetit profesional në shkollë për lëndën mësimore dhe/ose kriteret e vendosura nga dy mësimitdhënësit të cilët i realizojnë orët e përbashkëta mësimore.

Përveç kriterëve të vendosura për arritjen e rezultateve nga nxënia/qëllimet e përcaktuara në programin mësimor, mësimitdhënësit që udhëheqin orët e përbashkëta duhet të përgatisin dhe kriteret e përbashkëta për vlerësimin e qëllimeve interkulturore/rezultatet nga nxënia, që duhet të përmbushen si rezultat i orëve të përbashkëta mësimore.

Vlerësimin formativ dhe sumativ të nxënësve e bëjnë që të dy mësimitdhënësit. Vlerësimin dhe notimin e arritjes së qëllimeve interkulturore/rezultatet nga nxënia të planifikuara si rezultat i orëve të përbashkëta e bëjnë që të dy mësimitdhënësit në kuadër të lëndës së përbashkët mësimore.



SHTOJCAT

SHTOJCA 1 - RAPORTI PËR NDJEKJEN E ORËS SË PËRBASHKËT

SHTOJCA 2 - ROLI DHE DETYRAT E KOMUNAVE DHE QYTETIT TË SHKUPIT
NË MBËSHTETJE TË SHKOLLAVE PËR ORGANIZIMIN E ORËVE
TË PËRBASHKËTA MËSIMORE

SHTOJCA 3 - LLOJET TË AKTIVITETEVE PËR PERCEPTIMIN E MË SHUMË
PERSPEKTIVAVE



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e zhvillimit të arsimit
Ministry of Education and Science - Bureau for Development of Education



Центар за стручно образование и обука
Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim
Vocational Education and Training Centre

SHTOJCA1 - RAPORTI PËR NDJEKJEN E ORËS SË PËRBASHKËT

RAPORT

për ndjekjen e orës së përbashkët mësimore në distancë (onlajn)

Këshilltar: _____

Institucioni: _____

LISTA EVIDENTUESE PËR VIZITËN E ORËS SË PËRBASHKËT MËSIMORE

Data e vizitës:
Shkolla:
Komuna:
Lënda e mësimore:
Njësia e mësimore:
Paralelja/paralelet: 1. 2.
Numri i përgjithshëm i nxënësve: Paralelja 1 - Paralelja 2 - Gjithsej nxënës:
Numri i nxënësve që kanë marrë pjesë në orë, sipas gjinisë 1. Femra _____ 2. Meshkuj _____
Gjuha/gjuhët në të cilën/cilat realizohet mësimi në paralelet që mbajnë orën e përbashkët: 1. 2.
Emri dhe mbiemri i mësimitdhënësit / mësimitdhënësve: 1. 2.

Legjenda për shkallën e përbushjes së treguesve:

3 = Po, treguesi është përbushur plotësisht

2 = Pjesërisht, treguesi është përbushur deri diku

1 = Jo, treguesi nuk është përbushur

0 = Treguesi nuk është i përshtatshëm për aktivitetin e orës

KRITERET PËR VLERËSIMIN E ORËS SË PËRBASHKËT

PLANFIKIMI DHE PËRGATITJA E ORËS SË PËRBASHKËT

1. Aktivitet për planifikim dhe përgatitje	3	2	1	0
1.1 Planifikimi përgatitet bashkërisht nga mësuesit dhe gjuhëtarët ndryshe mësimore të cilët realizojnë orën e përbashkët mësimore.				
1.2 Planifikimi i orës së përbashkët buron nga planifikimi afatgjatë/afatmesëm i orëve të përbashkëta.				
1.3 Janë planifikuar rezultate ndërlëndore/qëllimet transversale/rezultatet nga nxënia që mundësojnë zhvillimin e kompetencave interkulturore.				
1.4 Qëllimet e planifikuara/rezultatet e pritura për orën mësimore për interkulturë janë të qarta dhe konkrete.				
1.5 Është parashikuar përdorimi i formave, metodave dhe teknikave bashkëkohore të të mësuarit të cilat mundësojnë mbështetjen dhe bashkëpunimin reciprok të nxënësve nga paralelet e ndryshme.				
1.6 Është planifikuar zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta (në grupe, çifte, etj.), duke respektuar kriteret për grupe të balancuara të nxënësve dhe duke përdorur gjuhët në të cilat nxënësit ndjekin mësimin.				
1.7 Janë përgatitur resurset e nevojshme, materialet didaktike për zbatimin/arritjen e qëllimeve / rezultatet e pritura nga ora e përbashkët (fletë pune në gjuhët në të cilat mbahet ora, etj.).				
1.8 Janë planifikuar aktivitetet për nxënësit (detyrat/ushtrimet për nxënësit) që kontribuojnë në punën e tyre të përbashkët dhe për përfundimin e interkulturës.				
1.9 Janë planifikuar aktivitete për secilin mësues individualisht në raport me mësuesin (përdorimin e barabartë të gjuhëve gjatë dhënies së instruksioneve dhe gjatë parafrazimeve).				
1.10 Aktivitetet e planifikuara për çdo pjesë të orës (pjesa hyrëse, kryesore dhe pjesa përfundimtare) janë të harmonizuara me nevojat, interesat, përkatësinë kulturore të nxënësve.				
1.11 Janë planifikuar punime/aktivitete të përbashkëta jashtë orës së përbashkët (detyrë e projektit, hulumtim...) si punë shtëpie me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëria.				
1.12 Janë planifikuar kriteret për vlerësimin e rezultateve / qëllimeve interkulturore të cilat arrihen në orën mësimore të përbashkët.				
1.13 Janë siguruar të gjitha parakushtet për zbatimin e sigurt të orës së përbashkët (mbrojtja nga aspekti psikik dhe fizik)				

REALIZIMI I ORËVE TË PËRBASHKËTA				
2. Aktivitetet e mësimdhënësit/mësimdhënëses gjatë realizimit të orës së përbashkët	3	2	1	0
2.1 Mësimdhënësit informojnë nxënësit për qëllimet/rezultatet e nxënies për lëndët mësimore dhe qëllimet transversale të interkulturalizmit, në mënyrë që është e kapshme për nxënësit.				
2.2 Mësimdhënësit përdorin format, metodat dhe teknikat e planifikuara të punës për sigurimin e punës së përbashkët të nxënësve (puna në grupe të balancuara nxënësish nga të dyja paralelet).				
2.3 Gjatë ndarjes të nxënësve në grupe dhe çifte, mësimdhënësit kujdesen për përfaqësimin e barabartë të nxënësve sipas përbërjes etnike/gjuhësore dhe gjinore.				
2.4 Mësimdhënësit i përfaqësojnë/përdorin në mënyrë të barabartë të dyja gjuhët gjatë orës mësimore.				
2.5 Gjatë mësimdhënies, mësimdhënësit parafrzojnë në mënyrë të përshtatshme në gjuhën tjetër, ligjërojnë, japin udhëzime për punën në grupe, në çifte, japin informacione kthyesë për të gjithë nxënësit dhe grupin e nxënësve.				
2.6 Mësimdhënësit tregojnë një shkallë të lartë të njohurive për përmbajtjet e lëndës dhe shfaqin të kuptuarit nga aspekti i interkulturalizmit.				
2.7 Mësimdhënësit paraqesin shembull/model të interkulturalizmit për nxënësit (kanë respekt reciprok, bashkëpunim dhe plotësim reciprok).				
2.8 Mësimdhënësi/mësimdhënësja përdor materialin didaktik (tekstual, ilustrativ, digjital), në përputhje me planifikimin, në gjuhët e orës së përbashkët mësimore.				
2.9 Në pjesën hyrëse të orës zhvillohen aktivitetet për njohjen/pranimin reciprok të nxënësve nga paralele të ndryshme (nëse bëhet fjalë për pesë orët e para).				
2.10 Zbatimi i aktiviteteve të planifikuara kontribuon për përforcimin e njohurive reciproke dhe interkulturalizmin.				
2.11 Mësimdhënësit nxjerrin përfundime/ bëjnë përmbledhje së bashku me të gjithë nxënësit, duke pasur parasysh që të gjithë të kontribuojnë njësoj në përfundimin e sjellë.				
2.12 Mësimdhënësit kontrollojnë nëse nxënësit kanë kuptuar çfarë duhet të punojnë gjatë orës.				
3.3. Pjesëmarrja aktive e nxënësve në orë të përbashkët mësimore	3	2	1	0
3.1 Nxënësit marrin pjesë në mënyrë aktive në diskutime të argumentuara dhe konstruktive për qëllimet/rezultatet e nxënies, gjatë të cilave të gjithë nxënësve iu sigurohet pjesëmarrje gjatë orës së mësimin.				
3.2 Nxënësit ndihmojnë dhe kujdesen për njëri-tjetrin, pa marrë parasysh se në cilën gjuhë ndjekin mësimin.				

3.3 Nxënësit dëgjojnë me kujdes gjatë mësimit që mbajnë mësimdhënësit, pa marr parasysh në çfarë gjuhe mbajnë mësim.				
3.4. Dëgjojnë me vëmendje gjatë nxënies së bashku me bashkënxënësit, pa marrë parasysh gjuhën me të cilën flasin bashkënxënësit.				
3.5 Parashtrojnë pyetje (mësimdhënësit/mësimdhënëses ose bashkënxënësit/bashkënxënëses) në gjuhën e tyre në lidhje me zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të orës së përbashkët.				
3.6 Janë të fokusuar në kryerjen e detyrës së përbashkët/nxënies me bashkënxënësit në grupe të balancuara/përziera nxënësish.				
3.7. Nxënësit pranojnë suksesin e të gjithë anëtarëve të grupit për punën e kryer si sukses të përbashkët.				
3.8. Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin objektivisht për përmbushjen e detyrës në përputhje me kërkesën e mësimdhënësit/mësimdhënëses, dhe jo sipas përkatësisë së paraleles dhe të gjuhës mësimore.				
4. Mësimdhënia gjatë orës së përbashkët	3	2	1	0
4.1 Gjatë orës së përbashkët mësimdhënësit demonstrojnë fleksibilitet dhe përshtatin metodat mësimore dhe shpejtësinë (tempon) e punës sipas mundësive të nxënësve.				
4.2 I kushtohet kohë shpjegimit në të dyja gjuhët, po ashtu edhe nevojave individuale të secilit nxënës/secilës nxënës.				
4.3 Aktivitetet e mësimdhënësit për çdo pjesë të orës përshtaten me mundësitë, nevojat, përkatësinë kulturore dhe dallimet e tjera mes nxënësve.				
4.3 Nxënësit me nevoja të posaçme të përfshirë në mësim mbështeten ashtu si duhet.				
4.4 Gjatë orës mësimdhënësi/mësimdhënësja ndjek ndërveprimin e nxënësve.				
4.5 Ata i shpjen nxënësit drejt rezultateve nga nxënia e lëndës, po aq sa edhe drejt rezultateve interkulturore transversale nga nxënia.				
4.6 Në pjesën e fundit të orës bëhet përmbledhja e punës së kryer dhe arritjeve edhe nga aspekti i interkulturës.				
4.7 Kontrollon arrijtja e rezultateve të pritura për interkulturë me aktivitet të duhur përfundimtar.				
5. Ndjekja, vlerësimi dhe notimi i arritjeve të nxënësve	3	2	1	0
5.1 Mësimdhënësit i njoftojnë nxënësit me kriteret për vlerësim të përparimit të tyre dhe nga aspekti i interkulturalizmit ³⁹ .				
5.2 Mësimdhënësit përdorin procedura dhe instrumente të ndryshme për ndjekjen e punës dhe arritjeve të nxënësve, përfshirë dhe matjen e treguesve/kritereve të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve nga interkultura.				

³⁹ Standardet për interkulturë dhe standardet nacionale të inkuadruara në programet e reja mësimore. www.bro.gov.mk

5.3 Gjatë orës së mësimi, mësimdhënësit vazhdimisht iu japin nxënësve informacione me gojë në gjuhët në të cilat mbahet ora e përbashkët.				
5.4 Mësimdhënësit mbajnë evidencë për ndjekjen dhe kontrollimin e përparimit të nxënësit edhe nga aspekti i përfuturit të njohurive për interkulturën.				
5.5 Mësimdhënësi/mësimdhënësja merr parasysh vlerësimin e nxënësve nga bashkëmoshatarët dhe kujdeset që nxënësit të jenë në përbërje të përzier sipas gjuhës mësimore.				
5.6 Instrumentet dhe teknikat për ndjekjen e arritjeve të nxënësve mundësojnë vlerësimin e progresit për secilin nxënës/secilën nxënës edhe nga aspekti i zhvillimit të njohurive interkulturore.				
6. Klima në klasën në të cilën mbahet ora e përbashkët	3	2	1	0
6.1 Mësimdhënësit tregojnë respekt ndaj nxënësve.				
6.1.1 Nxënësit mund të shprehin mendimin e tyre në gjuhën në të cilën ndjekin mësimin (gjuha amtare).				
6.1.2 Mësimdhënësit i dëgjojnë nxënësit me vëmendje dhe nuk i pengojnë pa marrë parasysh se cilit grupi etnik i përket nxënësi/nxënësja dhe/ose gjuhës me të cilën diskutojnë/përgjigjen/shpjegojnë nxënësit.				
6.1.3 Mësimdhënësit tregojnë respekt për mendimet e secilit nxënës në orën e përbashkët.				
6.1.4 Mësimdhënësit marrin parasysh nevojat dhe interesat e secilit nxënës gjatë mbajtjes së orës së përbashkët.				
6.1.5 Mësimdhënësit nuk komentojnë pamjen e nxënësve.				
6.1.6 Mësimdhënësit nuk bëjnë komente që stigmatizojnë.				
6.1.7 Mësimdhënësit nuk bëjnë dallime mes nxënësve bazuar në karakteristikat e tyre (përkatësia etnike, përkatësia e grupit/paralelja, etj.).				
6.1.8 Mësimdhënësit i trajtojnë të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë, dhe të gjithë nxënësit perceptohen njësoj të rëndësishëm.				
6.2. Mësimdhënësit nxisin respektin dhe bashkëpunimin reciprok mes nxënësve.				
6.2.1 Sjellja e nxënësve është sipas rregullave të vendosura për sjellje pozitive në orën mësimore, të miratuara së bashku me nxënësit. ⁴⁰				
6.2.2 Përgjigjet e nxënësve respektohen (pa marrë parasysh se në cilën gjuhë flet nxënësi) dhe nuk kritikohen nga ana e nxënësve të tjerë.				
6.3. Mësimdhënësit mbështesin/inkurajojnë vetëbesimin e nxënësve.				
6.3.1 Japin informata kthyes konstruktive për përparimin e nxënësve nga aspekti i aftësive dhe qëndrimeve interkulturore.				

⁴⁰ Rregullat (kodi) i sjelljes janë vendosur për të gjithë nxënësit në orën e përbashkët.

6.3.2 Japin informata kthyesë që nxjerrin në pah përpjekjet dhe punën e nxënësve për nxënien në grupe të përbashkëta.				
6.3.3 Shprehen pozitivisht për mundësitë/ aftësitë e nxënësit/nxënësës për përforsimin e interkulturës.				
6.3.4 Nxënësit nxiten mes tyre të bashkëpunojnë për të arritur të qëllimi i përbashkët, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike/gjuhësore.				
6.3.5 Ikonografia në klasë përfaqëson në mënyrë të përshtatshme përkatësinë etnike, religjioze dhe kulturore të nxënësve të orës së përbashkët.				
ANALIZA PAS REALIZIMIT TË ORËS SË PËRBASHKËT				
7. Diskutimi pas zbatimit të aktivitetit	3	2	1	0
7.1 Mësimdhënësit janë të vetëdijshëm për (mos) arritjen e qëllimeve/ rezultateve nga nxënia e orës së përbashkët.				
7.2 Mësimdhënësit detektojnë mangësitë për mosarritjet eventuale të qëllimeve/ rezultateve të nxënies ose lëshimet eventuale gjatë së orës së përbashkët.				
7.3 Mësimdhënësit ndajnë përgjegjësinë për (mos) suksesin.				
7.4 Duket qartë se ka vazhdimësi në procesin e udhëheqjes së orës mësimore të përbashkët.				
7.5 Vetëvlerësimi oral i orës së përbashkët nga mësimdhënësit bëhet me respekt reciprok për mendimin dhe qëndrimet dhe pa dominim.				
7.6 Mësimdhënësit bëjnë analiza dhe japin propozime për përmirësimin e planifikimit dhe të mbajtjes së orëve të përbashkëta.				
7.7 Mësimdhënësit japin sugjerime për përmirësimin e komunikimit, motivimit dhe atmosferës në shkollë.				

Realizimi i mësimdhënies në distancë⁴¹

1. Planifikimi i orës mësimore në distancë				
1.1 Mësimdhënësit kanë caktuar dhe kanë përgatitur mjete didaktike digjitale, po ashtu edhe alternativa të përshtatshme nëse ndonjë vegël e caktuar nuk funksionon gjatë orës së mësimi.	3	2	1	0
1.2 Mësimdhënësit kanë bërë përzgjedhje dhe/ose kanë krijuar materiale dhe resurse digjitale përkatëse, në të cilat respektohen principet e interkulturalizimit.				
1.3 Mësimdhënësit bëjnë kujdes që të gjitha resurset që përdoren gjatë orës të jenë të kontrolluara dhe të sigurta nga aspekti i interkulturalizmit, mbrojtjes së të dhënave personale të mësimdhënësit/mësimdhënëses dhe të nxënësve.				
1.4 Mësimdhënësit iu kanë dorëzuar/siguruar paraprakisht nxënësve materiale të nevojshme për përgatitjen e orës së përbashkët në distancë.				
1.5 Mësimdhënësit kanë planifikuar paraprakisht përdorimin e aktiviteteve sinkrone dhe asinkrone për arritjen e rezultateve/qëllimeve nga nxënia interkulturore.				
2. Atmosfera gjatë orës së përbashkët në distancë				
2.1 Mësimdhënësit ndjekin dhe kontrollojnë interesimin dhe fokusimin e nxënësve gjatë orës së përbashkët në distancë.	3	2	1	0
2.2 Mësimdhënësit nxisin mësimin e përbashkët/kolaborativ (bashkëpunues) të nxënësve përmes mjeteve didaktike digjitale përkatëse.				
2.3 Mësimdhënësit bëjnë kujdes për aspektet socio-emocionale të nxënies gjatë orëve të përbashkëta në distancë (bëjnë kujdes për mirëqenien e të gjithë nxënësve, ndjekin gjendjen emocionale, etj.).				
3. Mbajtja e orës mësimore në distancë				
3.1 Mësimdhënësit përdorin orën e përbashkët në distancë për diskutime, shpjegime dhe përfundime dhe kjo kontribuon për përforcimin e interkulturalizmit.	3	2	1	0
3.2 Ora në distancë mbahet sipas hapave të parashikuar në planifikimin nga aspekti i mbajtjes së orës së përbashkët në distancë.				
3.3 Mësimdhënësit përdorin mjetet digjitale përkatëse për kontrollimin e të kuptuarit dhe arritjeve të nxënësve për rezultatet interkulturore nga nxënia.				

⁴¹ Kjo pjesë plotësohet nëse ora e ndjekur zhvillohet në distancë.

VËSHTRIME DHE REKOMANDIME

1. Gjetjet e këshilltarit⁴² në lidhje me aktivitetet e ndërmarra nga mësimdhënësi/ mësimdhënësit dhe shkolla për përmirësimin e mësimin me përfshirjen e nxënësve në grupe të përziera (maksimumi 300 fjalë):

2. Informatat kthyesë që iu jepen mësimdhënësve gjatë vizitës (këshilla, rekomandime etj.) (maksimumi 300 fjalë):

2.1 Planifikimi i orës së përbashkët (maksimumi 300 fjalë):

2.2 Realizimi i orës së përbashkët (maksimumi 300 fjalë):

2.3 Përfshirja aktive e nxënësve gjatë orës (maksimumi 300 fjalë):

2.4 Mësimdhënia gjatë orës (maksimumi 300 fjalë):

2.5 Notimi i nxënësve (maksimumi 300 fjalë):

2.6 Klima në klasë (maksimumi 300 fjalë):

⁴² Bazuar në vizitën gjatë orës dhe informacionet e marra nga bashkëbisedimet me mësimdhënësin, shërbimin profesional dhe drejtorin/drejtoreshën e shkollës.

Shtojca 2. Roli dhe detyrat e komunave dhe Qytetit të Shkupit në mbështetjen e shkollave gjatë organizimit të orëve të përbashkëta mësimore

Përmes procesit të decentralizimit dhe bartjes së një pjesë të kompetencave të arsimit nga niveli qendror në atë lokal, komunat dhe Qyteti i Shkupit morën edhe një pjesë të përgjegjësisë për demokratizimin e shoqërisë. Kështu, në kuadër të kompetencave të tyre ligjore, komunat dhe Qyteti i Shkupit kanë detyrime të krijojnë kushte për një arsim të integruar dhe interkulturor. Megjithatë, nëse merret parasysh fakti se kompetencat e komunave dhe Qytetit të Shkupit në radhë të parë lidhen me financimin dhe administrimin e shkollave dhe krijimin e kushteve fizike të punës, lind pyetja legjitime se **cili është roli i komunës gjatë organizimit të orëve të përbashkëta mësimore** në shkollat e tyre në kuadër të procesit mësimor. Ose, a ka komuna mekanizma për veprim gjatë krijimit të procesit mësimor në shkolla?

Në bazë të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, çdo komunë ka mundësi të hartojë dokumentet e veta programore dhe strategjike përmes të cilave do të fuqizojë rolin e saj gjatë krijimit dhe zbatimit të politikave arsimore, në përputhje me nevojat dhe vizionet lokale për zhvillimin e arsimit dhe bashkësisë në tërësi. Prandaj, çdo komunë që ka qëllim të avancojë integrimin ndëretnik në arsim, duhet që politikatat e saj t'i kthejë në aktivitete dhe detyra konkrete në kuadër të:

1. Dokumenteve strategjike shumëvjeçare për avancimin e integrimin ndëretnik, të cilat do të sigurojnë qëndrueshmëri dhe zhvillim të politikave të sjella, dhe
2. Programeve vjetore të punës në fushën e arsimit

1. Strategjitë për avancimin e integrimin ndëretnik në arsim dhe pjesëmarrje rinore (në tekstin e mëtejme: Strategjia) është praktikë e mirë e komunave për mbështetjen dhe për zbatimin e aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore në shkolla edhe në nivelin e vetëqeverisjes lokale. Strategjitë⁴³ janë platformë e definuar ligjërisht në kuadër të së cilës mund të zhvillohen nisma, mes tjerash edhe për mbajtjen e orëve të përbashkëta me nxënësit që mësojnë në gjuhë të ndryshme. Sjellja e këtij dokumenti strategjik për komunat dhe Qytetin e Shkupit dhe për shkollat duhet të bëhet duke respektuar parimin e transparencës dhe inkluzivitetit, pra, duke përfshirë të gjithë anët relevante: shkollat, shërbimet komunale të arsimit, këshillin e komunave, kryetarët e komunave, përfaqësuesit e sektorit joqeveritar, etj., për të siguruar mbështetje të gjerë për zbatimin e nismës, në përputhje me karakteristikat dhe nevojat e komunave dhe potencialeve të tyre për ndryshim dhe zhvillim. Procedura e sjelljes së Strategjisë zakonisht bëhet në disa faza:

⁴³ Strategji lokale për integrimin ndëretnik në arsim dhe pjesëmarrjen e të rinjve që mbështesin zbatimin e aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore në shkolla përkrahen në 45 komuna përmes Projektit të USAID-it për integrimin ndëretnik të të rinjve në arsim (INRA), të realizuara nga QMEQ; në periudhën 2019-2020 janë sjellë strategji në 30 komuna (Qyteti i Shkupit, Kumanovë, Gostivar, Buteli, Strumicë, Tetovë, Sveti Nikollë, Kavadar, Strugë, Prilep, Veles, Dollnen, Vrapçisht, Probishtip, Gjevgjeli, Ohër, Resnje, Bogovinë, Staro Nagoriçane, Negotinë, Aerodrom, Qendër, Çair, Gazi Babë, Saraj, Gjorçe Petrov, Koçan, Bisilovë, Berovë, Vinicë), kurse në vitin 2021 ky proces po zbatohet edhe në 15 komuna të tjera të vendit (Dojran, Radovish, Çashkë, Zhelinë, Kërçovë, Vasilevë, Bogdanc, Kisella Vodë, Karposh, Manastir, Shuto Orizarë, Mavrovë dhe Rostushë, Dibër, Studeniçan).

1. Formimi i komisionit komunal për avancimin e integritimit ndëretnik në arsim dhe të pjesëmarrjes së të rinjve me qëllim të planifikimit, zbatimit dhe ndjekjes së aktiviteteve për kohezionin ndëretnik në shkolla, përmes aktit të cilin e sjell kryetari i komunës. Në komision bëjnë pjesë anëtarë nga radhët e administratës komunale, këshillit të komunës, drejtorët e shkollave, koordinatorët e ekipeve për integrim shkollor (EISH), këshillat e shkollave dhe këshillat e prindërve.
2. Komisioni ose grupi i punës i zgjedhur nga ai harton dokumentin strategjik - **Strategjia për avancimin e integritimit ndëretnik në arsim dhe pjesëmarrjes së të rinjve**. Pjesë përbërëse e Strategjisë është edhe plani i veprimit për zbatimin e saj, i cili përveç aktiviteteve dhe nismave specifike komunale, përfshin detyrimisht edhe elemente nga planet vjetore shkollore për integritimin ndëretnik. Ky komision zbaton edhe **Planin për matjen e arritjeve dhe vlerësimin e zbatimit**, të planit të veprimit të Strategjisë.
3. Pas miratimit të Strategjisë nga ana e këshillave të komunave, periudhë e rëndësishme e radhës është njohja e hollësishme dhe informimi i shkollave me qëllimet dhe detyrat e projektuara të planit për avancimin e bashkëpunimit ndëretnik nga ana e personave përgjegjës për arsim në administratën komunale. Në këtë mënyrë, përmes një raporti partneriteti dhe komunikimit të drejtpërdrejtë kryhen aktivitetet e planifikuara dhe iu jepet mundësi shkollave të zbatojnë në kohë aktivitetet përgatitore në ambientet e tyre shkollore.

2. Programi vjetor i komunës në fushën e arsimit është dokument në të cilin komuna planifikon projekte dhe aktivitete konkrete të cilat do të ndërmerren për realizimin e qëllimeve të caktuara, mes tjerash edhe qëllimi i lidhjes së nxënësve të përkatësive të ndryshme etnike përmes realizimit të përbashkët të orëve të rregullta mësimore. Në këtë dokument programor komuna regjistron fushat e veta me prioritet dhe financat e nevojshme për zbatimin e tyre. Prandaj është e nevojshme që kryetari i komunës dhe administrata komunale të bashkëpunojnë ngushtë me shkollat, për të parashikuar aktivitetet dhe masat konkrete që do të ndërmerren për secilën shkollë veç e veç.

Sigurimi i mbështetjes financiare për zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta mësimore

Për një zbatim sa më të suksesshëm të politikave arsimore që bazohen mbi dokumentet programore strategjike, duhet që komuna të sigurojë financa përkatëse në buxhetin e saj, si në atë njëvjeçar, ashtu edhe në atë disavjeçar.

Mbështetja financiare për zbatimin e aktiviteteve për realizimin e orëve të përbashkëta dhe të formave të tjera të lidhjes dhe bashkëpunimit ndëretnik sigurohet në dy mënyra:

- ▶ Në kuadër të buxheteve themelore të komunave
- ▶ Përmes ndarjes së bllok dotacioneve për shkollat

Programimi dhe buxheti janë procese që zhvillohen paralelisht në kuadër të mekanizmave të përcaktuar dhe procedurave ligjore. Në këtë mënyrë sigurohen supozimet themelore për sendërtimin dhe promovimin e kohezionit ndëretnik, përmes aktiviteteve të përbashkëta mësimore dhe jashtëmësimore të nxënësve të përkatësive etnike të ndryshme.

E çfarë duhet në fakt të planifikohet në kuadër të proceseve të programimit dhe buxhetimit të aktiviteteve të përbashkëta mësimore?

- ▶ Orët e përbashkëta duhet të jenë pjesë e dokumenteve programore të komunës nga njëra anë, por njëkohësisht duhet të pasqyrohen edhe në programet vjetore të punës së shkollave, e më pas edhe në organizimin e procesit mësimor të shkollës (në kuptimin e harmonizimit të orarit të punës së mësimdhënësve, numrit të orëve ose përqindjes së realizimit të planeve dhe programeve mësimore përmes orëve të përbashkëta para fillimit të vitit shkollor, etj.).
- ▶ Komuna luan rol në planifikimin e financave në pika të caktuara në **buxhetin e saj themelor**, si mbështetje e procesit të realizimit dhe promovimit të orëve të përbashkëta në shkolla. Komuna luan rol edhe gjatë **shpërndarjes së financave nga bllok dotacionet** në shkolla, të cilat i transferon pushteti qendror. Kështu, në bazë të procedurës përkatëse, komuna ka mundësi të mbështesë plane financiare shkollore të cilat parashikojnë financa për nxitjen dhe mbështetjen e aktiviteteve për komunikimin dhe ndërveprimin ndëretnik (për aktivitete të përbashkëta, pajisje ndihmëse mësimore, promovime, ekskursione, pajisje IT dhe të tjera, përfshirë edhe për orët mësimore të përbashkëta të cilat përfshijnë “a priori” forma dhe metoda pune interaktive).

Në këtë kontekst është me rëndësi të përmendet se ky proces duhet të shoqërohet me transparencë të plotë dhe me informimin e duhur dhe në kohë të të gjitha palëve të përfshira. Përveç kësaj, është e rëndësishme që autoritetet lokale të dëshmojnë kapacitet për partneritet me shkollat, dhe kjo do të mundësojë që bashkërisht të planifikojnë dhe të përshtatin dokumentet e nevojshme, të përgatisin në kohë mësimdhënësit dhe nxënësit-pjesëmarrësit në orët e përbashkëta, të informojnë prindërit e tyre, duke ndarë kështu vizionin dhe përgjegjësinë e përbashkët për qëllimet dhe dobitë e synuara nga këto aktivitete. Ky parim pune është resurs i rëndësishëm për njohjen dhe zgjidhjen e problemeve në proces të zbatimit, i cili vjen pas përcaktimit të dokumenteve programore dhe supozimeve organizative. Bashkëpunimi mes komunës dhe shkollave duhet të bazohet mbi këto parime pune: besimi i ndërsjellë, inkuziviteti dhe shkëmbimi i mendimeve, transparenca, përgjegjësia dhe barazia. Në fakt, integrimi ndëretnik dhe respektimi i të drejtave dhe dallimeve “të tjetrit” mund të avancohen vetëm në një ambient demokratik në të cilin marrin pjesë të gjitha subjektet e përfshira, të cilat kanë role dhe përgjegjësi të ndryshme.

Roli i komunave dhe Qytetit të Shkupit në zbatimin e orëve të përbashkëta mësimore

Fazat e realizimit të orëve të përbashkëta mësimore:

- ✓ Faza përgatitore – periudha para fillimit të vitit shkollor
- ✓ Faza e zbatimit – gjatë vitit shkollor
- ✓ Faza e ndjekjes dhe vlerësimit – që nga fillimi i aktiviteteve si proces vlerësimi dhe pas mbarimit të tyre, në fund të vitit shkollor, kur edhe vlerësohen rezultatet e zbatimit

Faza përgatitore duhet të përfshijë periudhën para fillimit të vitit të ri shkollor. Zakonisht duhet të nisë me takim mes personave të komunës përgjegjës për arsimin me drejtorët dhe koordinatorëve të EISH në shkolla, të cilët potencialisht mund të përfshihen në orët e përbashkëta. Kriteri kryesor për përzgjedhjen e shkollave në të cilat do të mbahen orë të përbashkëta është gatishmëria e drejtorit/drejtoreshës të/së shkollës dhe mësimdhënësve të nisin procesin e lidhjes dhe ndërveprimit të nxënësve që mbajnë mësim në gjuhë të ndryshme në kuadër të orëve të rregullta. Elementë të rëndësishëm të kësaj gatishmërie janë interesi i shprehur qartazi për pjesëmarrje dhe paraqitja vullnetare e mësimdhënësve.

Dihet se përballimi me një sfidë të tillë nënkupton njohjen e hollësishme me politikat arsimore të përmendura më sipër të hartuara në nivel komune dhe shkolle, si dhe motivim për zhvillimin e shkathtësive, kompetencave dhe qëndrimeve përkatëse për punën me paralele heterogjene nisur nga gjuha e nxënësve. Për këtë qëllim mund të përdoren pyetësor të ndryshëm për vlerësimin e motivimit të drejtorit/drejtoreshës dhe të mësimdhënësve të zbatojnë një lloj të këtillë të mësimdhënies. Përfaqësuesit komunalë që në fillim luajnë rolin e promotorëve të politikave të arsimit të integruar interkulturore dhe të mbështetësve aktivë të aktiviteteve të shkollave, që nga fillimi i sjelljes së vendimeve për pjesëmarrje e deri në mbajtjen e orëve.

Pas përzgjedhjes së shkollave vijohet me aktivitetet e tjera që bëhen në shkolla, në konsultim të vazhdueshëm me komunën:

- ✓ Zgjedhja e lëndëve që do t'i realizojnë bashkërisht nxënësit-përparësi kanë lëndët që kanë më shumë interaktivitet në procesin mësimor e më pak material teorik, pra lëndët që mësohen me metoda dhe teknike që kërkojnë më pak verbalizim në mësim, siç janë: arsimit/arti figurativ, arsimit/arti muzikor dhe arsimit shëndetësor/sporti dhe aktivitete sportive, gjuhët e huaja dhe mësimi praktik (në shkollat e mesme profesionale);
- ✓ Zgjedhja e mësimdhënësve që mbajnë orët dhe që kanë kompetenca dhe vetëbesim përkatës në shkathtësitë e tyre mësimore për menaxhimin e orës mësimore e cila është jashtëzakonisht e ndjeshme nga më shumë aspekte;
- ✓ Hartimi i planit dhe orarit të mbajtjes së orëve të përbashkëta në kuadër të orarit të përgjithshëm të punës së mësimdhënësve;

- ✓ Përfshirja e përfaqësuesve të ekipeve për integrim shkollor për të dhënë mbështetje aktive dhe përgatitja e mësimeve për realizimin e orëve të përbashkëta: organizimi i takimeve këshilluese dhe i trajnimeve fillestare për mësimeve;
- ✓ Informimi dhe sigurimi i mbështetjes nga këshilli i shkollës, i cili miraton programin vjetor të punës së shkollave, dhe nga drejtori/drejtoresha i/e shkollës në lidhje me orët e planifikuara të përbashkëta;
- ✓ Informimi i mbarë kolektivitetit dhe i të gjithë anëtarëve të bashkësisë së shkollës (këshilli i arsimtarëve, administrata dhe personeli teknik) nga ana e drejtorit/drejtoreshës dhe EISH;
- ✓ Përgatitja e të gjitha subjekteve të përfshira për informimin e duhur të prindërve të nxënësve që do të marrin pjesë në paralelet me orë të përbashkëta;
- ✓ Përmbledhja e gjendjeve dhe konsultimi me përfaqësuesit komunalë për sfidat aktuale.

Faza e zbatimit zgjat më shumë, pra gjatë gjithë muajve që realizohet mësimeve. Me nisjen e vitit shkollor, sipas orarit të përcaktuar, nis edhe realizimi i orëve të përbashkëta. Orët realizohen përmes ndjekjes dhe me ndihmën e mbështetjes konsultative dhe këshillëdhënëse nga ana e këshilltarëve të BZHA-së dhe QAPT-së. Në këtë fazë roli i komunës është të ofrojë mbështetje aktive në të gjitha aspektet e zbatimit të orëve të përbashkëta, edhe përmes takimeve të rregullta dhe mbledhjeve këshillëdhënëse me drejtorin/drejtoreshën dhe me koordinatorin e shkollës, për të zbuluar problemet dhe për të gjetur mënyrat për t'i tejkaluar ato. Në njëfarë kuptimi, komuna ka rolin e ndërmjetësit mes palëve dhe faktorëve të përfshirë, duke identifikuar nevojat e nxënësve, mësimeve dhe prindërve dhe duke siguruar mbështetje logjistike dhe financiare. Kjo përfshirje e komunës ndikon në ndërtimin e mbështetjes sistematike për shkollat që marrin pjesë aktive në avancimin e interaksionit (bashkëveprimin) ndëretnik mes të rinjve dhe në motivimin e tyre të përfshihen në reformat arsimore në ambientin shkollor, në klasa, duke reflektuar karakterin shumë kulturor dhe shumetnik të shoqërisë.

Gjatë gjithë muajve të realizimit është shumë e rëndësishme që komuna të iniciojë dhe të zbatojë aktivitete të ndryshme për promovimin e këtyre orëve përpara opinionit publik. Ajo duhet të sendërtojë praktikën e krijimit të dukshmërisë së këtyre proceseve në shkolla, përmes informimit të vazhdueshëm të trupave dhe forumeve eksperte, në mediat e informimit publik, përmes prezantimit të organizuar dhe shpërblimit të mësimeve dhe punës së tyre në këshillat e komunës dhe para publikut të gjerë. Të sigurojë afirmimin e vazhdueshëm të nxënësve dhe shkollave përmes faqes së internetit, përmes rrjeteve sociale, në mbledhjet e Komisionit të Arsimit, përmes adresimit të kryetarit të komunës pas miratimit të raporteve vjetore të shkollave, në radio, në kanalet televizive dhe portalet e internetit. Forma tërheqëse e mbështetjes është hartimi i një profili të veçantë në Facebook nga vetë Komisioni për Avancimin e Integritimit Ndëretnik në shkolla, aty ku do të përditësohen informacionet për aktivitetet e kryera për integrimin ndëretnik dhe

orët mësimore të përbashkëta, si afirmimi i orëve të përbashkëta përmes prodhimit të përmbajtjeve multimediale në internet, etj.

Faza e ndjekjes dhe vlerësimit zakonisht zbatohet pas mbarimit të vitit shkollor. Në bashkëpunim me shkollat dhe bartësit e projektit komuna duhet të fillojë procedurat për vlerësimin e rezultateve të realizimit. Për këtë qëllim përdoren pyetësorë dhe anketa përkatëse, për të mbledhur të dhëna për shkallën e përfundimit të bashkëveprimit mes nxënësve dhe mes mësimeve, për kënaqësinë nga pjesëmarrja në këto orë, si dhe të dhëna për shkallën e njohurive të përfituara përmes notave të lëndëve, të dhëna për përmirësimin e kompetencave të mësimeve përmes punës dhe bashkëpunimit kolegjial. Njëkohësisht, si mënyrë e ndjekjes dhe vlerësimit procesor (përmes procedurave sistematike për vëzhgim, intervistës dhe teknikave të tjera) mund të ndiqet dhe të vlerësohet suksesi me të cilin mësimeve menaxhojnë situata konfliktive, nismat e nxënësve, atmosfera e punës në klasë dhe aspektet e tjera të kohezionit. Të gjitha këto të dhëna komuna dhe shkollat duhet t'i kyçin në politikën dhe strategjinë e ardhshme për avancimin e integritetit ndërkulturore si parametër objektiv për planifikimin e jetës interkulturore reale në shkollë.

Shtojca 3. Lloje të aktiviteteve për perceptimin e më shumë perspektivave

Aktivite për perceptimin e më shumë perspektivave

Aktivitetet që përdoren në procesin mësimor mund të jenë verbale (ligjërim frontal, diskutime, përgjigje të pyetjeve, dramatizim, etj.), vizuale (ngjarje e incizuar, shfaqje, fotografi, afishe, etj.) të cilat mund të kombinohen dhe të plotësohen p.sh.: të lexohen, të krahasohen, të analizohen dhe të diskutohet tekstet e tre nxënësve që kanë prejardhje, vlera, norma, shkathtësi dhe njohuri të ndryshme, por që edhe flasin gjuhë të ndryshme.

Përmbledhja e përbashkët e aktiviteteve është shumë e rëndësishme në mënyrë që të dalë në pah nxënia nga përvoja dhe të dëshmohet se si lloji i tekstit dhe gjuha e përdorur ndikojnë mbi të kuptuarit. Mësimdhënësi/mësimdhënësja duhet të diskutojë me nxënësit për atë se pse njerëzit kanë tendencë që t'i shohin ndryshe dukuritë, ngjarjet ose ndodhitë, si dhe çfarë ndodh nëse i vlerësojmë gabimisht njerëzit duke u nisur nga përshtypja e parë dhe nga paragjykimet e gabuara për ta. Zhvillimi i kompetencave interkulturore në arsim duhet të arrihet përmes ndërmarrjes së më shumë aktiviteteve të ndryshme të cilat analizojnë më shumë perspektiva.

Për shembull: dy historianë që jetojnë në pjesë të ndryshme të qytetit dhe shkruajnë në gjuhë të ndryshme, shpeshherë i përshkruajnë ndryshe ngjarjet historike. Edhe portretin e të njëjtit person dy artistë të ndryshëm e pikturojnë ndryshe, ashtu ndodh edhe me skicat e vizatimet nga persona që rrinë ulur në kënde të ndryshme të së njëjtës klasë.

Perspektiva e shumëfishtë mund të përmirësohet përmes tregimit të përrallave dhe hartimeve të nxënësve, p.sh.: rrëfimi i përrallave (reale ose të imagjinuara) duke përfshirë njerëz të ndryshëm dhe specifikë. Përrallat mund të nxirren nga biografite e nxënësve, dhe kjo mund të realizohet si aktivitet në formë të lojës ku bëhet bashkim i pjesëve të tregimeve, ashtu që secila biografi paraqet një pjesë të lojës me qëllim që të theksohen dallimet e grupit dhe të detyrojë nxënësit të hulumtojnë njëri-tjetrin. Ky aktivitet mund të kryhet në orët e rregullta gjatë zhvillimit të kompetencave gjuhësore, por edhe gjatë zhvillimit të kompetencave transversale të futura në lëndët mësimore (të detyrueshme ose zgjedhore).

Luajtja e roleve, simulimi, drama

Aktivitetet me luajtjen e roleve, simulimit dhe dramës mund të realizohen në gjuhë amtare, në gjuhë të huaj, në gjuhën e huaj të dytë, ose në ndonjë gjuhë tjetër zgjedhore në orët e letërsisë për zhvillimin e kompetencave interkulturore të nxënësve. Për shembull: mësimdhënësit mund t'iu ndajnë nxënësve role sipas të cilave duhet të sillen ndryshe nga mënyra, normat dhe standardet sipas të cilave sillen zakonisht. Përveç kësaj, duhet të zgjidhin probleme ose të diskutojnë në grupe, duke ndjekur normat e „identitetit të tyre të ri“.

Dobitë nga metoda e luajtjes së roleve, simulimeve dhe dramës për zhvillimin e kompetencave interkulturore janë të shumta: nxënësit e ndiejnë në lëkurën e tyre

se cila është ndjenja të jesh ndryshe, të të shikojnë çuditshëm, të kritikohesh ose të të përjashtojnë. Ata do të kuptojnë se, ndonëse njerëzit janë të ndryshëm në ndonjë aspekt (si: ngjyra e syve, gjuha, besimi), këto ndryshime nuk i bëjnë më pak të vlefshëm si qenie njerëzore. Përmbledhja e aktivitetit me metodën e diskutimit është shumë e rëndësishme për ngritjen e vetëdijes se çfarë ka ndodhur gjatë lojës.

Përmes përmbledhjes zbulohet se çfarë kanë mësuar nxënësit, si janë ndier ndërkohë që kanë luajtur, çfarë ka qenë e lehtë, e rëndë, e çuditshme në rolin e ri ose sa kanë qenë në gjendje të përshtaten me normat e ndara me „identitetin e ri“ dhe nëse karakteri i tyre ka qenë stereotipik. Aktiviteti i realizuar me metodën e luajtjes së roleve, simulimeve dhe dramës e ngre vetëdijen për ngjashmëritë dhe dallimet, paragjykimet dhe rregullat për komunikimin verbal dhe jo verbal.

Leximi i dramës, poezisë dhe shkrimi kreativ (metoda tekstuale)

Aktiviteti që kontribuon të zhvillohen kompetencat interkulturore është leximi i teksteve dramaturgjike, poezive dhe shkrimi kreativ. Kur në kohën tonë të lirë shohim ose lexojmë dramë, mësojmë për njerëzit me kulturë të ndryshme. Leximi i dramës në orët e gjuhës amtare, gjuhëve të huaja, lëndës zgjedhore të letërsisë, dramës, etj., iu ndihmon nxënësve të mësojnë në mënyrë krejtësisht ndryshe.

Shumë tregime dhe poezi mundësojnë gjithashtu të zhvillohet kompetenca interkulturore. Ato mund të lexohen, të shijohen, të diskutohen, të ilustrohen me vizatime, të ritregohen duke shtuar pak fantazi dhe shkathtësi kreative nga perspektiva e nxënësve.

Këto aktivitete mundësojnë që nxënësit të përfitojnë njohuri për njerëzit që nuk i kanë takuar kurrë dhe të mësojnë për ta dhe për jetën e tyre, që nuk e kanë imagjinuar ndonjëherë. Këto aktivitete mund t’iu ndihmojnë nxënësve të zvogëlojnë paragjykimet për personat e tjerë.

Varësisht nga përmbajtja ose porosia e poezisë, tregimit ose tekstit dramatik, këto aktivitete mund t’iu ndihmojnë nxënësve të kuptojnë si mund ta mbrojnë dinjitetin dhe të drejtat e njeriut në shoqëri, pavarësisht nga përkatësia e tyre kulturore.

Detyrat etnografike

Detyrat etnografike nxënësve iu mundësojnë të hulumtojnë jetën reale me qëllimin që të marrin përvojë dhe njohuri që mund t’i krahasojnë, t’i analizojnë dhe të promovojnë vetëzbulimin dhe vetëgjykimin. Në orë nxënësit hulumtojnë se si përshëndeten njerëzit, cilat komunikime verbale dhe jo verbale përdoren për të shprehur respekt, mirënjohje, mlllef ose çfarëdo lloj emocioni tjetër. Një detyrë tjetër mund të jetë intervistimi i njerëzve që sillen në mënyrë specifike. Rezultatet e hulumtimit mund të prezantohen, të zbatohen dhe të analizohen në orë me qëllim të zhvillimit të qëndrimeve dhe shkathtësive të nevojshme për kompetencën interkulturore.

Diskutimet reflektive për përvojat etnografike do t'iu ndihmojnë nxënësve të mendojnë për reaksionet e tyre për atë që kanë vërejtur dhe kanë përjetuar gjatë „punës në terren“.

Aktiviteti mund të përdoret për tema të historisë, fjala vjen „historia gojore“, p.sh. gjyshet dhe gjyshërit iu rrëfejnë nipave/mbesave përralla për fëmijërinë e tyre; shpeshherë pjesëmarrësit befasohen nga dallimet mes tyre, mes lojërave, shkollave, etj. Ndonëse këto biseda rrallëherë mund të ndodhin, duhet t'iu jepet mundësi nxënësve të hulumtojnë si ka ndryshuar kultura e tyre me kalimin e kohës.

Filmat

Shikimi i filmave është aktivitet që takohet shpesh në arsim. Nga zgjedhja e filmit varet edhe interaksioni dhe përforcimi i kompetencave interkulturore. Mësimdhënësit mund të zgjedhin qëllimisht filma ose skena filmi për të biseduar për dallimet, ose përmes pyetjeve të diskutojnë për vështrimin e tyre ndaj ngjarjeve, ose të marrin parasysh perspektivën e bashkëndjesisë (dhembshurisë) me njerëzit të përfshirë në skenën e dhënë.

Këto skena ngrenë vetëdijen e nxënësve për gjykimin e tyre kritik.

Mediat sociale dhe veglat e tjera të internetit

Takimi me të tjerët përmes internetit sjell elemente të komunikimit ndërkulturor. Interneti mundëson shkëmbimin e qëndrimeve dhe mendimeve mes grupeve të mëdha dhe të ndryshme njerëzish, të cilët nuk do të mund të komunikonin dot ndryshe në mënyrë fizike. Në këtë kontekst zgjerimi i mediave sociale reflekton nevojën e njerëzve për të komunikuar.

Rrjetet sociale mund të kontribuojnë për zhvillimin e kompetencave interkulturore, nëse kanë të bëjnë me tema dhe çështje që janë të rëndësishme për kompetencat interkulturore.

Zhvillimi i kompetencave interkulturore mund të bëhet edhe përmes resurseve të ndryshme dhe materialeve që ndodhen në internet, të cilat mund të përdoren në lëndët e detyrueshme dhe ato zgjedhore e që kërkojnë prej tyre të kuptojnë dhe të interpretojnë informacionet dhe burimet e informacioneve. Tendenca e tanishme e rritjes së përdorimit të rrjeteve sociale dhe internetit në përgjithësi e rrit nevojën për zhvillimin e vetëdijes ndërkulturore dhe kompetencës interkulturore përmes përdorimit të tyre.

Kur përdoren si duhet, aktivitetet e ndërmarra përmes mediave sociale iu mundësojnë nxënësve të zhvillojnë qëndrime që iu ndihmojnë të menaxhojnë emocionet e tyre kur ndodhen përballë kuptimeve të dyfishta ose pasigurisë. Aktivitetet mundësojnë të bashkëpunojnë me persona të kulturave të tjera, të përftojnë shkathtësi për të dëgjuar njerëz me qëllim të zhvillimit të vetëdijes komunikuese, përfshirë këtu edhe faktin se gjuhët e bashkësive të tjera etnike mund të shprehin ide në mënyrë unike ose mund të shprehin ide unike të cilat mund të jetë e vështirë të shprehin në gjuhën e tyre.

